



Plani Vendor Social

Bashkia Pustec

2026-2028





Falenderime

Bashkia Pustec shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit Vendor Social 2026-2028. Ky proces është realizuar me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë (SHKBSSH) dhe me ekspertizën teknike të “Smart Processes”, të cilët lehtësuan analizën, planifikimin dhe ndërtimin metodologjik të këtij dokumenti strategjik.

Falënderojmë në mënyrë të veçantë Këshillin Bashkiak të Bashkisë Pustec, i cili ka mbështetur këtë proces duke siguruar një qasje të hapur dhe gjithëpërfshirëse në hartimin e planit.

Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive e sektorëve vendorë, organizatave të shoqërisë civile, grupeve komunitare dhe partnerëve lokalë që morën pjesë aktivisht në takime konsultative dhe ndihmuan në pasqyrimin e nevojave të vërteta të komunitetit.



Tabela e përmbajtjes

Falenderime	2
1. Hyrje	5
2. Metodologjia	5
3. Legjislacioni dhe Baza Ligjore	7
3.1 Kuadri kushtetues dhe ligjor	7
3.2 Kuadri ligjor ndërkombëtar	9
3.3 Roli i Bashkisë dhe Strukturave të tyre në ngritjen e Shërbimeve Sociale	9
3.4 Kategoritë e shërbimeve sociale	12
3.5 Modalitetet e ofrimit të shërbimeve	15
3.6 Kërkesa ligjore për profesionistët socialë	16
3.7 Prioritetet në zgjerimin e hartës së shërbimeve	16
4. Analiza e të dhënave- vështrim i përgjithshëm	17
4.1 Të dhëna demografike sipas gjinisë	17
5. Individë në Nevojë për Shërbime dhe Shërbimet Egzistuese	17
5.1 Individë që përfitojnë Ndihmë Ekonomike sipas njësive administrative	17
5.2 Individë që përfitojnë Ndihmë Ekonomike sipas gjinisë	18
5.3 Individë që përfitojnë Ndihmë Ekonomike sipas grupmoshës	19
5.4 Familjet aplikuese të ndihmës ekonomike	20
5.5 Familjet përfituese të ndihmës ekonomike	20
5.6 Karakteristikat e familjeve përfituese nga ndihma ekonomike	20
6. Strehimi Social	21
6.1 Numri i familjeve aplikuese për strehim social	21
6.2 Numri i aplikuesve për strehim që janë edhe përfitues të ndihmës ekonomike	21
6.3 Godina me infrastrukturë të përshtatshme për shërbime komunitare	22
6.4 Familje përfituese sipas programeve të strehimit	22
7. Punëkërkesit e papunë në Bashkinë Pustec	22
7.1 Punëkërkesit e papunë sipas njësive administrative	22
7.2 Punëkërkesit e papunë sipas Gjinisë	22
7.3 Grupet Vulnerabël të Punëkërkesve të Papunë	23
7.4 Trajnimet Profesionale	23
7.5 Bizneset në territorin e Bashkisë Pustec	23



8. Personat me Aftësi të Kufizuara	24
8.1 Identifikimi dhe Vlerësimi i Nevojave të Personave me Aftësi të Kufizuara	24
8.2 Karakteristikat e Aftësisë së Kufizuar	24
8.3 Shërbimi i strehimit social	25
8.4 Përfituesit nga skema e mbrojtjes sociale – Invalidët e Punës.....	25
8.5 Shërbimi Shëndetësor	26
9. Viktima të dhunës në familje	27
9.1 Dhuna në Familje	27
9.2 Identifikimi dhe Adresimi i Nevojave të Viktimave të Dhunës	28
9.3 Mbështetje për Viktimat e Dhunës në Familje	29
10. Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje	29
10.1 Identifikimi dhe Menaxhimi i Rasteve të Fëmijëve	29
10.2 Numri i fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.....	30
10.6 Shërbimet Psiko-Sociale në Shkolla.....	34
10.7 Masat lehtësuese të Bashkisë për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.....	34
11. Familjet rome dhe egjiptiane	35
12. Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale	35
12.1 Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale sipas njësive administrative	35
12.2 Shërbimet e kujdesit shoqëror për të moshuarit	36
13. Personat me varësi nga droga dhe nga alkooli	36
13.1 Identifikimi i rasteve me varësi nga substancat	36
13.2 Numri i rasteve të raportuara.....	37
14. Migrantët dhe Emigrantët	37
15. Shërbimet Bazë që ofron Bashkia Pustec	38
16. Kapacitetet e bashkisë	40
17. Vizioni dhe Misioni	42
18. Qëllimet dhe Objektivat.....	42
19. Plani i Veprimit	44
20. Monitorimi dhe raportimi	64
21. Bibliografi	66



1. Hyrje

Plani Social i Bashkisë Pustec për periudhën 2026-2028 është një dokument strategjik që udhëheq vendimmarrjen në fushën e shërbimeve sociale në nivel vendor, në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe zhvillimit gjithëpërfshirës. Hartimi i këtij plani është zhvilluar në periudhën Maj-Korrik 2025, përmes një procesi konsultativ dhe të bazuar në evidencë, nën koordinimin e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale.

Ky proces u mbështet nga ekspertë të fushës dhe u orientua nga praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare për planifikimin social. Bashkia Pustec ka ndërtuar një përvojë të vyer ndër vite në adresimin e nevojave të grupeve vulnerabël, duke konsoliduar shërbime dhe partneritete në nivel vendor dhe rajonal.

Plani synon të analizojë gjendjen ekzistuese të shërbimeve sociale në territor, të identifikojë boshllëqet dhe sfidat, si dhe të përkufizojë objektiva të qarta për periudhën trevjeçare 2026-2028. Dokumenti është hartuar në përputhje me legjislacionin kombëtar, strategjitë përkatëse sektoriale dhe standardet minimale të shërbimeve, duke integruar gjithashtu kontributet e komunitetit dhe aktorëve të shumtë lokalë.

Përmes këtij Plani, Bashkia Pustec synon të fuqizojë sistemin komunitar të mbrojtjes dhe kujdesit social, të përmirësojë aksesin, cilësinë dhe gjithëpërfshirjen e shërbimeve, si dhe të rrisë kapacitetet institucionale për të përmbushur me përgjegjësi misionin e saj ndaj qytetarëve më në nevojë.

2. Metodologjia

Procesi i hartimit të Planit Social për Bashkinë Pustec është zhvilluar përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, e mbështetur në të dhëna, konsultim me aktorët lokalë dhe orientim drejt standardeve kombëtare. Më poshtë paraqiten hapat e ndjekur:

1. Analiza e kuadrit ligjor dhe strategjik kombëtar

Fillimisht u realizua një shqyrtim i detajuar i dokumenteve ligjore dhe strategjike që udhëheqin planifikimin e politikave sociale në nivel kombëtar. Në fokus ishin:

- Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030;
- Ligji 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024;
- Strategjia për PAK, barazinë gjinore, të moshuarit dhe grupet vulnerabël,
- Kuadri i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG-të) në nivel vendor.

Kjo analizë shërbeu për të përcaktuar detyrimet dhe prioritetet që bashkia duhet të adresojë në nivel lokal.



2. Konsultimi me aktorë lokalë dhe ofrues shërbimesh

U zhvilluan takime konsultative me një gamë të gjerë aktorësh, për të siguruar që prioritetet e planit të reflektojnë realisht nevojat dhe perspektivat në terren. Këtu përfshihen:

- Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe stafi teknik i bashkisë,
- Administratorë vendorë dhe përfaqësues të njësive administrative,
- Përfaqësues të shoqërisë civile dhe organizatave që ofrojnë shërbime sociale,
- Partnerë të tjerë ndërinstitucionalë (arsimi, shëndetësia, policia, etj).

3. Analiza e të dhënave sociale dhe administrative

U mbledhën dhe u analizuan të dhëna të detajuara nga burime të ndryshme, përfshirë:

- Sistemi elektronik i shërbimeve sociale,
- Të dhëna administrative nga bashkia dhe njësitë administrative,
- Regjistrat e ndihmës ekonomike, PAK, pensione dhe shërbimeve ekzistuese,
- Statistikat e INSTAT dhe institucioneve kombëtare të monitorimit social.

Kjo analizë ndihmoi në identifikimin e grupeve në nevojë, shportës së shërbimeve ekzistuese, dhe zonave me mungesa të theksuara në mbulim.

4. Vlerësimi i boshllëqeve në raport me standardet kombëtare

Bazuar në standardet e shërbimeve të kujdesit shoqëror të miratuara nga Ministria përkatëse, u krye një vlerësim i kapaciteteve dhe mbulimit aktual në Bashkinë Mat. Ky vlerësim ndihmoi në:

- Identifikimin e boshllëqeve në infrastrukturë dhe burime njerëzore,
- Përcaktimin e shërbimeve të reja të nevojshme,
- Prioritizimin e ndërhyrjeve për periudhën 2026-2028.

5. Hartimi i objektivave dhe Planit të Veprimit

Bazuar në të dhënat, konsultimet dhe boshllëqet e evidentuara, u formulua struktura logjike e Planit Social, përfshirë:

- Objektivat strategjike dhe specifike,
- Masat konkrete të ndërhyrjes,
- Treguesit e monitorimit,
- Aktorët përgjegjës dhe afatet për zbatim.



3. Legjislacioni dhe Baza Ligjore

Shqipëria ka zhvilluar kuadrin ligjor mbi mbrojtjen dhe përfshirjen sociale duke rregulluar kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, fëmijëve, moshuarve, viktimave të dhunës në familje etj. Një rol të vecantë në ngritjen dhe fuqizimin e shërbimeve sociale kanë edhe bashkitë.

Kjo rubrikë synon të paraqesë një përmbledhje të qartë, të strukturuar dhe të zbatueshme të shërbimeve sociale që ofrohen në nivel vendor në Republikën e Shqipërisë. Ai shërben si një udhëzues praktik për bashkitë dhe institucionet e tjera të përfshira në projektimin, ofrimin dhe monitorimin e këtyre shërbimeve, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të përmbushin nevojat e individëve dhe grupeve në nevojë.

Standardet minimale përcaktojnë nivelin themelor të cilësisë, disponueshmërisë dhe aksesueshmërisë që një shërbim social duhet të përmbushë. Ato janë element thelbësor për sigurimin e një ofrimi të barabartë dhe të pandryshueshëm të shërbimeve në të gjitha bashkitë, mbështetjen e punës profesionale të strukturave vendore dhe ofruesve të tjerë të licencuar si dhe promovimin e transparencës, përgjegjshmërisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm në ofrimin e ndihmës sociale.

Dokumenti mbështetet në:

- Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030;
- Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026;
- Ligji 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”
- Ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale”;
- Ligjin nr. 163/2014 “Për urdhrin e punonjësit social”;
- Aktet nënligjore që rregullojnë shërbime specifike si: VKM për standardet e shërbimeve për fëmijë, për PAK, për të moshuar, viktimat të dhunës, etj.;
- Konventa ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, si Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

3.1 Kuadri kushtetues dhe ligjor

Garantimi i shërbimeve sociale në Shqipëri mbështetet në parimet themelore të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në **Kreun V-Objektivat Socialë**, përmes **Neni 59**, shteti angazhohet të përmbushë detyrimet e tij ndaj qytetarëve në nevojë, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon. Këto objektiva përfshijnë promovimin e punësimit, sigurimin e të drejtës për strehim, aksesin në shërbime shëndetësore dhe arsim, përkujdesjen për të moshuarit, jetimët, invalidët dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës për shtresat më të cënueshme të shoqërisë. Ky kuadër normativ përbën themelin mbi të cilin ndërtohen politikat dhe programet për mbrojtjen sociale dhe përfshirjen e barabartë të qytetarëve në jetën shoqërore dhe ekonomike.



Ligjet kryesore përfshijnë:

Ligji 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024;	Ky ligj vendos bazat e organizimit dhe funksionimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke theksuar rolin qendror të bashkive në planifikimin, sigurimin dhe financimin e këtyre shërbimeve, si dhe në monitorimin e cilësisë dhe zbatimin e standardeve minimale.
Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”	Sanksionon se bashkitë kanë kompetencë ekskluzive për të ofruar dhe organizuar shërbime sociale për banorët e tyre. Neni 24 “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve: 1. Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. 2. Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. 3. Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore. 4. Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale”	Regullon ndihmën ekonomike dhe përfshirjen e bashkive në procesin e identifikimit, vlerësimit dhe miratimit të përfituesve të skemës së ndihmës.



Ligji nr. 163/2014 “Për urdhrin e punonjësit social”	Vendos rregulla për profesionin e punonjësit social, përfshirë kriteret e edukimit, etikës dhe licencimit. Ky ligj lidhet drejtpërdrejt me standardet për personelin që ofron shërbime sociale.
---	---

3.2 Kuadri ligjor ndërkombëtar

Shqipëria është palë nënshkruese dhe ratifikuese e disa konventave ndërkombëtare që ndikojnë drejtpërdrejt në politikëbërjen dhe standardizimin e shërbimeve sociale. Gjithashtu Shqipëria është në process të përafrimit të legjislacionit me BE në kuadër të procesit të antarësimit. Këto instrumente ndërkombëtare janë reflektuar në legjislacionin kombëtar dhe përbëjnë bazën për monitorim ndërkombëtar dhe përgjegjshmëri në zbatimin e të drejtave sociale.

Në konventat kryesore të ratifikuara nga shteti shqiptar mund të listojmë:

- **Konventa për të Drejtat e Fëmijës (CRC)**

Kërkon ofrimin e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror dhe vendos standarde për trajtimin e fëmijëve në institucionet sociale.

- **Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (CRPD)**

Neni 19 thekson të drejtën për jetesë të pavarur dhe përfshirje në komunitet me mbështetjen e duhur.

3.3 Roli i Bashkisë dhe Strukturave të tyre në ngritjen e Shërbimeve Sociale

3.3.1 Kompetencat ligjore të bashkive

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, bashkitë kanë kompetencë ekskluzive për ofrimin e shërbimeve të kujdesit dhe ndihmës sociale në territorin e tyre. Konkretisht, bashkitë janë përgjegjëse për:

- Identifikimin e nevojave sociale të komunitetit
- Planifikimin dhe krijimin e shërbimeve të përshtatshme në nivel vendor
- Menaxhimin dhe financimin e shërbimeve
- Monitorimin e cilësisë dhe përputhshmërisë me standardet kombëtare

Ky rol është i detyrueshëm dhe jo fakultativ, dhe është i lidhur ngushtë me mekanizmin e vlerësimit të performancës së njësive të vetëqeverisjes vendore.

3.3.2 Struktura përgjegjëse brenda bashkisë

Neni 36 i Ligjit 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024, përcakton qartë përgjegjësitë e bashkive në ofrimin dhe administrimin e shërbimeve sociale në territorin e tyre. Roli i bashkisë është shumëdimensional dhe fillon me identifikimin dhe vlerësimin e nevojave sociale, të cilat



realizohen në bazë të hartës së vulnerabilitetit. Këto të dhëna përdoren më pas për të hartuar Planin Social Vendor, një dokument strategjik që përkthen nevojat në politika konkrete shërbimi.

Bashkia është përgjegjëse për programimin e buxhetit vendor dhe për përcaktimin e shportës bazë të shërbimeve shoqërore që duhet të ofrohen për komunitetin. Për realizimin e këtyre shërbimeve, ajo mund të kontraktojë ofrues të jashtëm përmes procedurave të prokurimit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, bashkia ka detyrimin të bashkërendojë punën me Shërbimin Social Shtetëror, për të siguruar që shërbimet të jenë të përputhshme me standardet kombëtare dhe të orientuara drejt nevojave reale të individëve.

Për të garantuar një administrim funksional, ligji parashikon ngritjen e strukturave të posaçme për kujdesin shoqëror brenda vetë bashkisë, si dhe njësi vlerësimi dhe referimi në çdo njësi administrative, në varësi të saj. Gjithashtu, parashikohet që për çdo 6,000 deri në 10,000 banorë të caktohet një punonjës social nga bashkia, për të siguruar mbulimin e duhur dhe përgjigje efektive ndaj nevojave sociale.

Nenet 47 dhe 48 të Ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” përcaktojnë funksionimin e strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki dhe rolin kyç të drejtuesit të saj.

Sipas Nenet 47, struktura për shërbimet shoqërore pranë bashkisë ka një mandat të gjerë që shtrihet përtej shërbimeve sociale të zakonshme. Ajo është gjithashtu organi kryesor për çështjet e mbrojtjes së fëmijës, duke ndërmarrë masa nëpërmjet koordinimit me drejtoritë e tjera bashkiake, mekanizmat vendorë të mbrojtjes, dhe institucione të tjera. Kjo strukturë raporton rregullisht kryetarit të bashkisë dhe këshillit bashkiak mbi situatën e fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Një funksion thelbësor i saj është ngritja e grupit teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijës, si në nivel bashkie, ashtu edhe në nivel të njësive administrative, duke koordinuar dhe mbikëqyrur aktivitetet e tij.

Ndërkohë, Neni 48 përcakton detyrat e drejtorit të kësaj strukture, i cili është autoriteti përgjegjës për marrjen e vendimeve mbi masat e mbrojtjes së fëmijëve, bazuar në vlerësimet e punonjësve të mbrojtjes së fëmijës dhe grupit teknik. Drejtori luan një rol kyç në miratimin dhe koordinimin e ndërhyrjeve ndërsektoriale, në zbatim të Planit Individual të Mbrojtjes, si dhe në organizimin e shërbimeve emergjente të mbrojtjes 24-orëshe, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit. Po ashtu, ai është përgjegjës për prokurimin e shërbimeve që nuk mund të ofrohen nga strukturat shtetërore, për monitorimin e aksesit të fëmijëve në të drejta, dhe për raportimin periodik mbi veprimtarinë e njësive të mbrojtjes së fëmijës.

Referuar Ligjit për barazinë gjinore në Shqipëri, organet e qeverisjes vendore bashkëpunojnë ngushtë me qeverinë qendrore dhe organizatat jofitimprurëse për zbatimin e politikave të barazisë gjinore në territorin që mbulojnë. Ata kryejnë mbledhjen dhe përpunimin e statistikave



lokale të ndara sipas gjinisë dhe emërojnë nëpunës përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore, duke siguruar një mekanizëm efektiv koordinimi dhe monitorimi.

3.3.3 Parimet themelore në ofrimin e shërbimeve sociale

Shërbimet shoqërore administrohen në bazë të parimeve universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë në bazë të këtyre parimeve themelore:

a) Parimi i universalitetit. Shërbimet e kujdesit shoqëror janë krijuar, funksionojnë dhe mbikëqyren bazuar në një sistem rregullash ligjore që ofrojnë garanci të mjaftueshme për t'u zbatuar në mënyrë të njëjtë për përfituesit që ndodhen në të njëjtat kushte.

b) Parimi i drejtësisë sociale. Çdokush ka detyrim të sigurojë kushtet bazë të jetesës për veten dhe personat, për të cilët ka detyrim ligjor t'i mbështesë dhe çdokush ka detyrim të kontribuojë me punën, të ardhurat dhe pasuritë e tij/saj për reduktimin e gjendjes së varfërisë së tij/saj apo të anëtarëve të familjes, veçanërisht fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë që nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre.

c) Parimi i subsidiaritetit. Shërbimet e kujdesit shoqëror ofrohen sa më pranë qytetarëve dhe për sa është e mundur nga strukturat vendore.

ç) Parimi i mbështetjes shoqërore. Subjektet, të cilat përmbushin kushtet për të përfituar nga shërbimet e kujdesit shoqëror, kanë të drejtën e përdorimit të tyre në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe për aq kohë sa janë në kushtet e vështirësisë e të pamundësisë.

d) Parimi i deinstitutionalizimit. Shërbimet e kujdesit shoqëror sigurohen dhe ofrohen, për aq sa është e mundur, pranë familjes ose komunitetit të përfituesit të shërbimit, me qëllim sigurimin e mirëqenies shoqërore dhe përdorimin me efikasitet të fondeve.

dh) Parimi i partneritetit. Funksionimi i sistemit të shërbimeve shoqërore bazohet në një bashkëpunim të ngushtë midis qeverisjes qendrore dhe vendore, si financues kryesorë të shërbimeve shoqërore me organizatat jofitimprurëse dhe subjektet e tjera jopublike, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre ofrimin e shërbimeve shoqërore për individët dhe familjet që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

e) Parimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfituesit. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, integritetit të individit, besimit fetar dhe formimin e gjithanshëm të tij.

ë) Parimi i mosdiskriminimit. Ndalohet çdo formë e diskriminimit të përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

f) Parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Të dhënat personale të individit, që trajtohet me shërbime të kujdesit shoqëror, janë konfidenciale dhe mbrohen e përpunohen sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Punonjësi social, si dhe çdo person tjetër i angazhuar në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror ruan




konfidencialitetin e të dhënave personale të individit, subjekt të këtij ligji, për të cilat ka marrë dijeni si pasojë e funksionit apo detyrës që kryen. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit shtrihet edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, funksionit apo detyrës.

3.4 Kategoritë e shërbimeve sociale

Bazuar në ligjet e marra në analizë dhe aktet nënligjore, bashkitë kanë detyrimin të ofrojnë këto lloje të shërbimeve sociale për grupet në nevojë:

3. Shërbime për fëmijët




Dokument referencë:

- ✓ Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, sidomos nenet 32-39, që parashikojnë shërbimet për fëmijët në nevojë për mbrojtje, kujdes alternativ dhe përfshirje sociale.
- ✓ Ligjit 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024, përcaktojnë detyrimet e bashkive për shërbimet për fëmijët.
- ✓ Udhëzimi nr. 6, datë 27.09.2016, “Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve në komunitet”, që përfshin standardet për qendrat ditore dhe shërbimet psiko-sociale.



- ✓ Udhëzimi nr. 33, datë 23.11.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e mekanizmit të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor”, i cili rregullon shërbimet e mbrojtjes së fëmijës, përfshirë emergjencën dhe strehimin e përkohshëm.

B. Shërbime për persona me aftësi të kufizuara (PAK)




Dokument 13reference:

- ✓ Ligji nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, I cili përcakton të drejtën për shërbime sociale të përshtatura dhe gjithëpërfshirëse në komunitet.
- ✓ Ligji 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024, sidomos nenet 6, 12, 16, 17, 22, 23, që detyrojnë bashkitë të ofrojnë shërbime për PAK sipas standardeve.
- ✓ Udhëzimi nr. 6, 13efe 27.09.2016, “Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve në komunitet”, që përfshin standardet për qendrat ditore dhe shërbimet e kujdesit në familje për PAK.
- ✓ Vendimi I Këshillit të Ministrave nr. 110, 13efe 6.3.2019, “Për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin për përfitimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për PAK”.



C. Shërbime për të moshuarit




Dokument 14reference:

- ✓ Ligjit 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024 përcakton përgjegjësinë e bashkive për ofrimin e shërbimeve për të moshuarit, duke përfshirë kujdesin në banesë dhe strehimin afatgjatë.
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 425, 14efe 27.05.2015, “Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve në institucione rezidenciale publike dhe jopublike për të moshuarit”.
- ✓ Udhëzimi nr. 6, datë 27.09.2016, “Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve në komunitet” – përfshin edhe qendrat ditore dhe shërbimet në banesë për të moshuarit.
- ✓ Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030, e cila thekson zgjerimin e shërbimeve komunitare për të moshuarit, veçanërisht për ata pa mbështetje familjare.
- ✓ Ligji nr. 9355, 14efe 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, I ndryshuar – thekson nevojën për mbështetje për shtresat vulnerabël, përfshirë të moshuarit.



D. Shërbime për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit



Dokument 15eference:

- Ligj Nr.9669, Datë 18.12.2006 “Për Masa Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare” (i ndryshuar)
- VKM Nr. 327, Datë 2.06.2021 “Për Mekanizmin e Bashkërendimit të Punës Ndërmjet Autoriteteve Përgjegjëse për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare, si dhe Procedimin e tij për Mbështetjen e Rehabilitimin e Viktimave eë Dhunës”

3.5 Modalitetet e ofrimit të shërbimeve

Shërbimet e kujdesit shoqëror, sipas mënyrës së financimit, klasifikohen në shërbime publike dhe jopublike.

- **Në shërbimet shoqërore publike** përfshihen shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat komunitare, qendrat rezidenciale, qendrat ditore ose në shtëpi. Këto shërbime financohen nga Buxheti i Shtetit dhe nga buxhetet vendore të organeve të qeverisjes vendore.




- **Shërbimet jopublike** klasifikohen në shërbime fitimprurëse dhe jofitimprurëse. Shërbimet shoqërore fitimprurëse nuk mund të kërkojnë apo përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit dhe ai i bashkive. Shërbimet shoqërore jofitimprurëse gëzojnë të drejtën të kërkojnë apo përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit apo ai i bashkive, vetëm nëse kanë lidhur kontratë me subjektin që ka përgjegjësi për të ofruar shërbimin e kujdesit shoqëror. Në shërbimet shoqërore jopublike përfshihen shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat rezidenciale, në qendrat ditore ose në shtëpi nga subjekte jopublike.
- **Shërbimet shoqërore të specializuara** janë pjesë e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ofrohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe nga njësitë e qeverisjes vendore në nivel qarku.

3.6 Kërkesa ligjore për profesionistët socialë

Sipas Ligjit nr. 163/2014 “Për urdhrin e punonjësit social” dhe Ligjit 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024, çdo shërbim social duhet të ketë të paktën një punonjës social të licencuar, i cili është përgjegjës për vlerësimin, planifikimin, ndjekjen dhe dokumentimin e ndërhyrjeve. Punonjësit socialë duhet të jenë të diplomuar në fushën përkatëse dhe të kenë licencë aktive nga Urdhri i Punonjësit Social. Në rastin e shërbimeve për fëmijë, përfshihet edhe psikologu me përvojë në çështje të mbrojtjes së fëmijëve.

3.7 Prioritetet në zgjerimin e hartës së shërbimeve

Bashkia Pustec ka prioritet zgjerimin e hartës së shërbimeve me shërbimet:





4. Analiza e të dhënave- vështrim i përgjithshëm

4.1 Të dhëna demografike sipas gjinisë

Sipas të dhënave të marra nga **Gjendja Civile**, numri total i banorëve në Bashkinë Pustec është **5,058**.

Shpërndarja gjinore e popullsisë është si më poshtë:

- **Femra:** 2,438 banore – që përfaqësojnë **48.21%** të popullsisë;
- **Meshkuj:** 2,620 banorë – që përfaqësojnë **51.79%** të popullsisë.

Këto të dhëna tregojnë një **raport gjinor të balancuar**, me një prirje të lehtë në favor të popullsisë mashkullore, gjë që është në përputhje me tendencat demografike në zonat rurale të vendit.

5. Individë në Nevojë për Shërbime dhe Shërbimet Egzistuese

5.1 Individë që përfitojnë Ndihmë Ekonomike sipas njësive administrative

Sipas të dhënave të marra nga **Spektori i Shërbimit Social dhe Ndihmës Ekonomike**, në Bashkinë Pustec janë regjistruar **195 individë** si përfitues të ndihmës ekonomike.

Në raport me numrin total të popullsisë në bashki (5,058 banorë), përfituesit përbëjnë rreth **3.85% të popullsisë**.

Kjo përqindje është relativisht e ulët në krahasim me **mesataren kombëtare për zonat rurale**, ku në disa raste përfituesit arrijnë deri në **9–10%** të popullsisë, dhe nevoja për mbështetje është edhe më e lartë, pasi **rreth 60%** e popullsisë rurale konsiderohet në rrezik varfërie (sipas Eurostat dhe analizave të Bankës Botërore).

Kjo mund të nënkuptojë disa gjëra:

1. **Mbulim i kufizuar i skemës**
– Mund të ketë kritere të forta për përfitim, që përjashtojnë shumë individë të nevojshëm.
2. **Nën-raportim i nevojës**
– Familjet që kanë nevojë për ndihmë mund të mos jenë të regjistruara në sistem, ose nuk aplikojnë për shkak të mungesës së informacionit apo burokracive.
3. **Migrim dhe strukturë demografike**
– Popullsia në Pustec është tkurrur ndjeshëm vitet e fundit. Një pjesë e madhe e atyre që kanë mbetur mund të jenë pensionistë me njëfarë mbështetje, ose individë të punësuar informal.



4. Politika lokale më efektive ose më kufizuese


– Mund të ketë politika vendore që ose mbështesin më mirë ekonominë familjare, ose kufizojnë ndihmën për shkak të burimeve të kufizuara.

5.2 Individë që përfitojnë Ndihmë Ekonomike sipas gjinisë

Raporti gjinor është relativisht i balancuar, me një prirje të lehtë në favor të meshkujve. Kjo është e pazakontë për skemat e ndihmës ekonomike në zona rurale, ku zakonisht gratë (kryesisht kryefamiljare ose në moshë pensioni) janë më të përfaqësuara. Mund të nënkuptojë:

- Prani më të madhe të burrave të papunë;
- Mungesë të aplikimit të grave për shkak të barrierave institucionale ose kulturore;
- Rol të fortë të burrave si aplikues për familjet.

Rekomandohet një analizë e mëtejshme për të zbuluar nëse ka gra në nevojë që nuk janë përfituese aktualisht.



Ky është grafiku që paraqet ndarjen gjinore të individëve përfitues të ndihmës ekonomike në Bashkinë Pustec:



- **Femra:** 48.21%
- **Meshkuj:** 51.79%

5.3 Individë që përfitojnë Ndihmë Ekonomike sipas grupmoshës

Nga totali prej **195 individësh që përfitojnë ndihmë ekonomike**, të dhënat tregojnë këtë shpërndarje sipas grupmoshave:

- **Grupmosha 0–17 vjeç:** 32 përfitues,
 - **Grupmosha 18–40 vjeç:** 55 përfitues,
 - **Grupmosha 41–60 vjeç:** 80 përfitues,
 - **Grupmosha mbi 60 vjeç:** 28 përfitues,
-
- **Grupmosha 0–17 vjeç (32 përfitues)**
Këtu përfshihen fëmijët dhe të rinjtë nën 18 vjeç. Kjo shifër tregon numrin e të miturve që jetojnë në familje të cilat marrin ndihmë ekonomike, duke pasur nevojë për mbështetje ekonomike për shkak të kushteve të vështira familjare.
 - **Grupmosha 18–40 vjeç (55 përfitues)**
Ky grup përfshin të rinjtë dhe të rriturit në moshë pune. Numri tregon sa individë në këtë moshë mbështeten nga skema e ndihmës ekonomike, ndoshta për shkak të papunësisë ose kushteve të tjera ekonomike që i bëjnë të pamundur sigurimin e të ardhurave të qëndrueshme.
 - **Grupmosha 41–60 vjeç (80 përfitues)**
Ky është grupmosha e të rriturve në moshë më të avancuar, afër ose në prag të pensionimit. Numri i madh në këtë kategori tregon se një pjesë e konsiderueshme e njerëzve të kësaj moshe në Pustec kanë nevojë për mbështetje ekonomike, ndoshta për shkak të vështirësive në gjetjen e punës ose problemeve shëndetësore.
 - **Grupmosha mbi 60 vjeç (28 përfitues)**
Në këtë grup përfshihen personat në moshë pensioni ose më të vjetër. Kjo shifër tregon se edhe pleqtë në Bashkinë Pustec kanë nevojë për ndihmë ekonomike, që mund të jetë për shkak të pensioneve të ulëta ose mungesës së të ardhurave të tjera.

Në përgjithësi, kjo shpërndarje tregon që ndihma ekonomike në Pustec mbulon të gjitha grupmoshat, duke i ndihmuar familjet dhe individët në nevojë në çdo fazë të jetës.

Rekomandime:

1. **Hartimi i një harte sociale** për të identifikuar vendbanimet me densitet më të lartë përfituesish të ndihmës ekonomike;
2. **Promovimi i mundësive për punësim** ose vetëpunësim për grupmoshën 19–64 vjeç, përmes bashkëpunimit me Zyrat e Punës dhe programet kombëtare të punësimit;
3. **Mbështetje shtesë për gratë**, veçanërisht ato që nuk janë të përfshira aktualisht në skema ndihme, përmes informimit, trajnimeve dhe qasjes më të lehtë në aplikime;



4. **Programe mbështetëse për fëmijët e familjeve në ndihmë ekonomike**, në bashkëpunim me shkollat dhe qendrat shëndetësore;
5. **Shërbime për të moshuarit vulnerabël**, si ndihmë në banesë, vizita në terren, ose ngritja e një shërbimi komunitar të lëvizshëm.

5.4 Familjet aplikuese të ndihmës ekonomike

Sipas të dhënave zyrtare të raportuara nga sektori përkatës, në Bashkinë Pustec janë regjistruar **48 familje** që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike. Ky tregues është i rëndësishëm për të vlerësuar shkallën e varfërisë në nivel familjar dhe për të përcaktuar nevojat reale për mbështetje sociale në komunitet.

5.5 Familjet përfituese të ndihmës ekonomike

Sipas të dhënave të siguruara nga Sektori i Shërbimit Social:

- **48 familje kanë aplikuar** për ndihmë ekonomike;
- **15 familje janë përfituese**;

5.6 Karakteristikat e familjeve përfituese nga ndihma ekonomike

27.08 % e familjeve përfituese janë të kryesuara nga gra, çka është tregues i rëndësishëm për ekspozimin e tyre ndaj varfërisë dhe nevojën për politika të fuqizimit ekonomik dhe social të grave, përmes:

- përfshirjes në tregun e punës,
- aksesit në arsim profesional,
- mbështetjes për kujdesin ndaj fëmijëve.

33.33% e familjeve kanë deri në 2 fëmijë të mitur, duke theksuar nevojën për mbështetje të integruar për fëmijët: libra, ushqim, transport, përfshirje në qendra komunitare apo aktivitete arsimore.

10.42 % e familjeve kanë anëtarë me aftësi të kufizuara (PAK). Kjo është një përqindje domethënëse dhe nënvizon nevojën për:

- qasje të barabartë në ndihmën ekonomike,
- akses në shërbime shëndetësore e sociale,
- ofrimin e asistencës në shtëpi apo përkrahje për integrim në jetë të pavarur.
- **40% e familjeve përfituese kanë pjesëtarë në moshë pensioni.**

Ne Bashkinë Pustec nuk egziston komuniteti Rom/Egjiptianë.

Numri mesatar i pjesëtarëve në familjet përfituese: 3 persona për familje.



Karakteristika	Përqindja (%)
Të kryesuar nga gra	27.08%
Me deri në 2 fëmijë të mitur	33.33%
Me anëtarë me aftësi të kufizuara (PAK)	10.42%
Me pjesëtarë në moshë pensioni	40.00%
Familje nga komuniteti rom/egjiptian	0.00%
Numri mesatar i pjesëtarëve për familje	3 persona

6. Strehimi Social

6.1 Numri i familjeve aplikuese për strehim social

Në Bashkinë Pustec, gjatë periudhës së raportuar, janë regjistruar **14 familje që kanë paraqitur kërkesë për tu trajtuar me nje nga programet sociale te strehimit Permiresimi i banesave sociale**. Kjo shifër ndonëse e vogël në vlerë absolute, është e rëndësishme në kontekstin e një bashkie me popullsi të ulët si Pusteci (5,058 banorë), pasi reflekton një **nevojë reale për përmirësim të kushteve të banimit**.

Kërkesat për strehim mund të vijnë nga:

- familje në gjendje ekonomike të vështirë;
- familje me shtëpi të amortizuara ose të pabanuara;
- të rinj të martuar pa mundësi për të ndërtuar banesë;
- gra kryefamiljare pa mbështetje;
- persona me aftësi të kufizuara ose familje me PAK që nuk kanë kushte të përshtatshme banimi.

6.2 Numri i aplikuesve për strehim që janë edhe përfitues të ndihmës ekonomike

Nga **15 familje që kanë paraqitur kërkesë për tu trajtuar me nje nga programet sociale te strehimit Permiresimi i banesave** vetëm 5 prej tyre janë njëkohësisht përfituese të ndihmës ekonomike. Kjo do të thotë se rreth 36% e aplikuesve për strehim janë në kushte të dokumentuara varfërie dhe përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike.

- Ky tregues është veçanërisht i rëndësishëm për të kuptuar **mbivendosjen e nevojave sociale**: strehimi dhe ndihma ekonomike shpesh shkojnë bashkë në rastet e varfërisë ekstreme.



- Prania e 9 familjeve të tjera që kanë kërkuar strehim por nuk janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike mund të sinjalizojë raste të:
 - individëve që jetojnë në varfëri “të padokumentuar”,
 - mospranim nga skema e ndihmës ekonomike për shkak të kritereve të rrepta,
 - apo nevoja të veçanta (emigrim, kthim nga emigracioni, ndarje familjare, dhunë në familje etj.)

6.3 Godina me infrastrukturë të përshtatshme për shërbime komunitare

Në Bashkinë Pustec **nuk ekziston asnje shërbim që mund ti ofrohet qytetarit** si qendra sociale, qendra ditore për fëmijë, të moshuar, PAK apo për grupe të tjera në nevojë.

6.4 Familje përfituese sipas programeve të strehimit

Sipas të dhënave nga Sektori i Shërbimit Social dhe Ndihmës Ekonomike, Bashkia Pustec ka mbështetur **15 familje përmes programit të përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese**, ndërkohë që në Bashkinë Pustec nuk është trajtuar ndonjerherë programi I strehimit social (banesa sociale me qira, banesa me kosto të ulët, etj.).

10 meshkuj dhe 5 femra

7. Punëkërkesit e papunë në Bashkinë Pustec

7.1 Punëkërkesit e papunë sipas njësive administrative

Në Bashkinë Pustec janë **vetëm 10 individë të regjistruar si punëkërkes përfitues të ndihmës ekonomike në grupmoshën 19–64 vjeç** në zyrën përkatëse të punësimit në Korçë informacion i marre nga Sektori i Ndihmes Ekonomike dhe Shërbimi Social.

Per sa i perket per familjet e tjera informacionin e sakte sa jane regjistruar si punkerkues e ofron Zyra e punes Korçe.

7.2 Punëkërkesit e papunë sipas Gjinisë

Ndër 10 punëkërkesit e regjistruar në zyrën e punës në Pustec:

- Gratë përfaqësojnë vetëm 40% të totalit, gjë që mund të interpretohet në disa mënyra:
 - barrierat që gratë përballen për të hyrë në tregun e punës (kujdesi për fëmijët, stereotipe gjinore, mungesë transporti);
 - mungesë informacioni ose përjashtim social i grave, veçanërisht në komunitetet rurale;



- ose përfshirje e grave në punë informale të paregjistruara (bujqësi, ekonomi shtëpiake, ndihmë familjare).
- Burrat janë më të përfaqësuar në regjistrim (60%), por kjo nuk do të thotë që janë më të papunë – thjesht mund të jenë më të prirur të regjistrohen.

7.3 Grupet Vulnerabël të Punëkërkuesve të Papunë

Vetëm 1 punëkërkuese është kryefamiljare grua.

Nuk ka punëkërkues të regjistruar nga kategoritë Rome/Egjiptiane, Emigrantë, apo PAK (Persona me Aftësi të Kufizuara).

7.4 Trajnimet Profesionale

Të dhënat tregojnë një mungesë totale të shërbimeve aktive të tregut të punës në Bashkinë Pustec. Ndërkohë që janë të regjistruar 10 persona të papunë në moshë pune (të gjithë përfitues të ndihmës ekonomike), nuk rezulton të jenë ofruar:

- asnjë trajnim profesional,
- asnjë përfitim nga trajnime,
- dhe asnjë ndërmjetësim për punësim.

Kjo situatë reflekton një mospërputhje të theksuar midis nevojave të të papunëve dhe ndërhyrjeve aktive të tregut të punës, duke rritur rrezikun e mbetjes afatgjatë në skemën e ndihmës ekonomike.

7.5 Bizneset në territorin e Bashkisë Pustec

Sipas të dhënave të raportuara nga sektori i tatim-taksave, **në Bashkinë Pustec janë të regjistruara gjithsej 17 biznese.**

- Ky numër është jashtëzakonisht i ulët, duke marrë parasysh sipërfaqen dhe nevojat socio-ekonomike të zonës.
- Një treg me kaq pak biznese nuk mund të mbështesë punësim të qëndrueshëm apo zhvillim lokal, sidomos në një situatë kur papunësia dhe varësia nga ndihma ekonomike janë të larta.
- Për më tepër, mungesa e një sektori aktiv privat i ul ndjeshëm edhe mundësinë për të ofruar praktika profesionale për të rinjtë dhe gratë, duke ndikuar negativisht në integrimin e grupeve vulnerabël në tregun e punës.
- Numri total i bizneseve të vogla të regjistruara: **17**
- Numri i bizneseve të regjistruara deri më 31.12.2024: **18**
- Numri i bizneseve të mbyllura gjatë vitit 2024: **1**
- Numri i bizneseve informale: **0**



- Fusha kryesore e aktivitetit ekonomik: **Peshkimi**

8. Personat me Aftësi të Kufizuara

8.1 Identifikimi dhe Vlerësimi i Nevojave të Personave me Aftësi të Kufizuara

Për të garantuar një përgjigje të mirëstrukturuar dhe gjithëpërfshirëse ndaj nevojave të personave me aftësi të kufizuara, Bashkia Pustec ndjek një qasje të bazuar në katër hapa kryesorë:

1. Regjistrimi dhe evidentimi

Realizohet përmes grumbullimit të të dhënave nga strukturat përkatëse (shërbimi social vendor, zyrat e ndihmës ekonomike, QKMF, OJF-të), me qëllim krijimin e një databaze të përditësuar për individët me aftësi të kufizuara që jetojnë në territorin e bashkisë.

2. Vlerësimi i nevojave individuale dhe familjare

Çdo rast trajtohet në mënyrë të veçantë përmes vlerësimeve multidisiplinare, që marrin në konsideratë jo vetëm diagnozën mjekësore, por edhe kushtet ekonomike, sociale, mjedisore dhe nevojat për mbështetje.

3. Planifikimi i shërbimeve dhe ndërhyrjeve

Bazuar në vlerësimet individuale, strukturat e bashkisë planifikojnë ofrimin e shërbimeve të personalizuar që përfshijnë ndihmën ekonomike, aksesin në arsim, transport të asistuar, pajisje ndihmëse, shërbime në banesë dhe përfshirjen në aktivitete komunitare.

4. Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm

Procesi përfshin ndjekjen periodike të çdo rasti për të siguruar që shërbimet e ofruara janë efektive, për të bërë rregullime në kohë reale dhe për të përmirësuar përgjigjen institucionale ndaj nevojave në ndryshim të individëve.

Ky proces i strukturuar lejon një qasje më të drejtë dhe efikase, si dhe rrit përgjegjshmërinë e institucioneve lokale për përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara.

8.2 Karakteristikat e Aftësisë së Kufizuar

Të dhënat e disponueshme për Bashkinë Pustec tregojnë se janë evidentuar gjithsej **47 persona me aftësi të kufizuara (PAK)**, të ndarë në kategoritë si më poshtë:

- **35 individë me aftësi të kufizuara fizike ose mendore** (kategoria më e madhe),
- **10 individë me probleme të shikimit,**



- **2 individë** të klasifikuar si **paraplegjikë ose tetraplegjikë**.

1 mashkull

1 femer

Kjo shpërndarje tregon nevojën për një ofertë të diferencuar shërbimesh, me fokus të veçantë për:

- pajisje ndihmëse dhe aksesueshmëri për personat me aftësi fizike të kufizuara,
- mbështetje në shërbimet e kujdesit personal dhe në familje,
- shërbime të dedikuara për personat me probleme të shikimit (p.sh. orientim dhe mobilitet, materiale në formate të aksesueshme),
- qasje psiko-sociale për individët me probleme mendore ose nevoja për përfshirje më të lartë sociale.

8.3 Shërbimi i strehimit social

Në Bashkinë Pustec, rezultojnë 2 persona me aftësi të kufizuara (AK) që kanë përfituar realisht nga programet e strehimit social. Ky tregues ka rëndësi të veçantë pasi sinjalizon që përpjekjet institucionale nuk janë vetëm në nivel aplikimi, por janë materializuar në mbështetje konkrete për të paktën një pjesë të individëve në nevojë.

Krahasuar me të dhënat e mëparshme, ku gjithashtu rezultuan 2 aplikues për strehim social nga radhët e personave me AK, kjo përputhje sugjeron:

- Se çdo aplikim i dorëzuar nga persona me aftësi të kufizuara është trajtuar dhe përkrahur pozitivisht.
- Bashkia ka demonstruar një qasje efikase dhe gjithëpërfshirëse, duke garantuar akses të barabartë në strehim.

8.4 Përfituesit nga skema e mbrojtjes sociale – Invalidët e Punës

Në Bashkinë Pustec, **janë regjistruar gjithsej 46 individë invalidë të punës** që përfitojnë nga skema e mbrojtjes sociale. Kjo përfaqëson një kategori të veçantë përfituesish me nevoja të vazhdueshme për mbështetje ekonomike dhe shërbime të përshtatura.

-17 femra

-29 meshkuj



8.5 Shërbimi Shëndetësor

- Qendra shëndetësore: 2
- Ambulanca: 8
- Poliklinika: 0
- Spital: ✕ *Nuk ka*
- Kapacitet spitali (shtretër): 0
- Prania e spitalit në qytet: Jo

Shërbimet shëndetësore në Pustec mbështeten në rrjetin e qendrave shëndetësore dhe ambulancave. Mungesa e një spitali dhe e një poliklinike përbën kufizim serioz në ofrimin e kujdesit të specializuar dhe të dytësor. Kjo nënkupton varësi nga bashki të tjera për shërbime më të avancuara.

Burimet Njerëzore

- Numri i mjekëve dhe infermierëve në spital (në dispozicion lokal): 18
- Numri i psikologëve aktivë në qendrat shëndetësore: 0

Stafi ekzistues prej 18 mjekësh dhe infermierësh është një burim i rëndësishëm, por mungesa e psikologëve vë në dukje boshllëkun në mbështetjen për shëndetin mendor.

Shëndeti i Fëmijëve dhe Riprodhues

- % e fëmijëve të vaksinuar: Të dhëna jo të disponueshme
- Norma e vdekshmërisë foshnjore: 0
- Numri i vizitave për shëndetin riprodhues në 2024: 0

Mungesa e vizitave për shëndetin riprodhues dhe e të dhënave për vaksinimin sugjerojnë nevojë për ndërgjegjësim, raportim dhe akses më të mirë për nënat dhe fëmijët. Mungesa e rasteve mund të lidhet me mungesën e ndjekjes mjekësore, jo domosdoshmërisht me mungesën e nevojës.

Shëndeti Mendor dhe Zhvillimi i Hershëm

- Raste të trajtuara me probleme të shëndetit mendor: 1
- Fëmijë të diagnostikuar me autizëm: 0



- **Fëmijë me çrregullime të tjera zhvillimore: 0**

Mungesa e kapaciteteve profesionale (psikologë, logopedë) dhe mungesa e të dhënave për diagnoza zhvillimore tregojnë se kjo fushë është praktikisht e pa trajtuar në nivel lokal. Ndërhyrjet e hershme janë të domosdoshme, sidomos në bashkitë me popullsi të shpërndarë.

✓ **Pikat e Forta**

- Prani e 8 ambulancave dhe 2 qendrave shëndetësore.
- Mbështetje sociale për persona me aftësi të kufizuara.

⚠ **Sfidat Kryesore**

- Mungesa e një spitali dhe shtretërve spitalorë.
- Mungesë psikologësh dhe specialistësh të shëndetit mendor.
- Mungesë totale e vizitave për shëndetin riprodhues dhe zhvillimin fëmijëror.
- Mungesë të dhënash për vaksinimin e fëmijëve.

9. Viktima të dhunës në familje

9.1 Dhuna në Familje

Të dhënat për vitin përkatës:

- **Raste të dhunës në familje të raportuara: 5**
- **Urdhra mbrojtjeje të lëshuara: 5**

Urdhra mbrojtjeje të monitoruara: 5

- 3 femra
- 2 meshkuj

Raportimi i 5 rasteve tregon se fenomeni i dhunës në familje është i pranishëm edhe në një bashki të vogël si Pusteci. Duke marrë parasysh përmasat demografike të bashkisë, kjo përbën një tregues i rëndësishëm për vëmendje institucionale.

Të gjitha rastet e raportuara janë ndjekur me lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe po aq janë edhe urdhrat e mbrojtjes të monitoruar – çka tregon një **reagim të koordinuar institucional**, me ndjekje të rasteve sipas protokolleve ligjore.



9.2 Identifikimi dhe Adresimi i Nevojave të Viktimave të Dhunës

Në Bashkinë Pustec, funksionon një mekanizëm ndërsektorial i koordinuar për identifikimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje, i cili angazhon aktorë të ndryshëm institucionalë në përmbushjen e rolit të tyre, bazuar në legjislacionin kombëtar dhe udhëzimet përkatëse.

Komponentët kyç të mekanizmit dhe rolet përkatëse:

Njësia për Mbrojtjen e Familjes (NJMF)

- Pika e parë e kontaktit për sinjalizimin e rasteve të dhunës.
- Kryen vlerësimin e rrezikut dhe nevojave të familjes, në përputhje me formularët dhe udhëzimet standarde.
- Ofron këshillim psiko-social, informim dhe orientohet drejt shërbimeve të nevojshme (strehim, shëndetësi, ndihmë ekonomike).
- Përfshin familjen në skemën e ndihmës ekonomike, kur verifikohet gjendja sociale dhe ekonomike e rënduar.

Policia e Shtetit

- Reagon menjëherë ndaj denoncimeve për dhunë në familje, kryen hetime paraprake dhe ndërhyr për të mbrojtur viktimën.
- Siguron raportimin e rasteve në sistemin TIMS, harton procesverbale dhe përgatit dokumentacionin për prokurorinë dhe gjykatën.
- Mundëson shoqërimin ose ndalimin e autorit kur është e nevojshme.

Sistemi Shëndetësor

- Ofron kujdes mjekësor emergjent dhe shërbime diagnostike për viktimat e dhunës (kontrolle, mjekime, referime).
- Plotëson raportin mjeko-ligjor, i cili ka vlerë në procesin gjyqësor.
- Në rastet e dhunës psikologjike ose të shëndetit mendor, shërbimet shëndetësore duhet të përfshijnë edhe psikologë dhe psikiatër, nëse janë të disponueshëm.

Gjykatat

- Marrin në shqyrtim kërkesat për Urdhër Mbrojtjeje të Menjëhershme (UMM) dhe Urdhër Mbrojtjeje (UM), bazuar në provat e sjella nga NJMF ose Policia.
- Vendosin për largimin e autorit nga banesa, ndalimin e kontaktit me viktimën dhe masa të tjera mbrojtëse.
- Njoftojnë NJMF për vendimin, që të mundësohet zbatimi dhe monitorimi i tij.



9.3 Mbështetje për Viktimat e Dhunës në Familje

Sipas të dhënave të mbledhura, në Bashkinë Pustec rezulton viktimat e dhunës në familje kanë përfituar ndonjë formë shërbimi si:

- **2 viktima** kanë përfituar **Ndihmë Ekonomike**, si pjesë e mekanizmit të mbrojtjes sociale.
- **2 viktima** kanë përfituar **këshillim psikologjik dhe ligjor** nga vetë bashkia.
 - 2 femra
 - 2 meshkuj

Mungesë përfitimesh në këto shërbime:

- **Strehimi social:** 0 përfitues
- **Punësimi ose ndihma për aktivizim ekonomik:** 0 përfitues
- **Shërbime të specializuara për fëmijët e viktimave:** 0 fëmijë të përfshirë

10. Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

10.1 Identifikimi dhe Menaxhimi i Rasteve të Fëmijëve

Bashkia ka një rol kyç në identifikimin, vlerësimin dhe mbrojtjen e fëmijëve që ndodhen në situata rreziku. Ky proces mbështetet në kuadrin ligjor dhe nënligjor për mbrojtjen e fëmijës (Ligji Nr. 18/2017, VKM Nr. 91, udhëzimet përkatëse), dhe realizohet përmes strukturave të posaçme si Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës (NMF) dhe Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës (PMF).

Etapat kryesore të procesit janë:

1. Identifikimi dhe regjistrimi i rastit

- Realizohet përmes sinjalizimeve nga institucione të tjera (shkolla, qendra shëndetësore, policia), komuniteti apo nga vetë familja.
- Regjistrimi bëhet në Regjistrin Vendor dhe Sistemin Kombëtar të Mbrojtjes së Fëmijës (RVMF/SMF).

2. Vlerësimi fillestar dhe i thelluar



- PMF kryen një vlerësim të menjëhershëm për të kuptuar nivelin e rrezikut dhe nevojat e fëmijës.
- Nëse rasti kërkon ndërhyrje të thelluar, pasohet me vlerësim të detajuar shumë-dimensional (familjar, shëndetësor, edukim, etj.)

3. Zhvillimi dhe zbatimi i Planit Individual të Mbrojtjes (PIM)

- Draftohet një Plan Mbrojtjeje i personalizuar, me masa konkrete, afate dhe aktorë përgjegjës.
- PIM përfshin ndihmë psiko-sociale, akses në arsim, kujdes shëndetësor, strehim emergjent, ndihmë ekonomike, etj.

4. Monitorimi dhe rishikimi i PIM

- Bashkia, përmes PMF, ndjek zbatimin e planit në mënyrë periodike (muajore ose sipas rastit).
- Plani rishikohet kur ka ndryshim në situatën e fëmijës ose kur masat nuk japin rezultat.

5. Mbyllja ose referimi i rastit

- Rasti mbyllet kur fëmija nuk ndodhet më në rrezik ose kur janë përmbushur objektivat e PIM.
- Në raste të rënda, rasti i referohet shërbimeve të specializuara ose autoriteteve qendrore.

6. Monitorimi pas mbylljes së rastit

- Është fazë shumë e rëndësishme për parandalimin e rikthimit të rrezikut.
- Bashkia dhe PMF mbajnë kontakte me familjen dhe fëmijën, për të garantuar që përmirësimi është i qëndrueshëm.

10.2 Numri i fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

Të dhënat e raportuara, tregojnë se nuk ka fëmijë në nevojë për mbrojtje. Po kjo e dhënë mund të tregojë edhe një mungesë të evidentimit, raportimit dhe ndoshta mungesë kapacitetesh për menaxhimin institucional të rasteve.

Kjo mbivendoset me të dhënat që dërguat më parë, ku:

- nuk ka qendra sociale për fëmijë,
- nuk ka fëmijë përfitues nga shërbime,
- nuk ka psikologë në strukturat shëndetësore,
- mungon mbështetja e drejtpërdrejtë për fëmijët viktime të dhunës.



10.3 Shpërndarja e mbulimi i shërbimeve Arsimore dhe Parashkollore

Rrjeti arsimor i Bashkisë Pustec është organizuar në mënyrë që të **përbushë nevojat e komunitetit lokal** në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Institucionet janë të vendosura në pika strategjike që mundësojnë mbulim të gjerë dhe akses të qëndrueshëm, duke reduktuar distancat për fëmijët dhe nxënësit dhe duke kontribuar në **përfshirjen sociale dhe zhvillimin e komunitetit**.

Lista e Shkollave dhe vendndodhja

Emri i Shkollës	Vendndodhja	Nivelet që ofron
Shkolla e Bashkuar “Dy Dëshmorët”	Pustec	Kopsht, Fillore, 9-vjeçare, Mesme
Shkolla “Rezistenca e Goricarëve”	Gorna Gorica	Kopsht, Fillore
Shkolla Fillore Tuminec	Tuminec (Kallamas)	Kopsht, Fillore
Shkolla Fillore Leska	Leska (Lajthizë)	Kopsht, Fillore
Shkolla Fillore Shulin	Shulin (Diellas)	Kopsht (shkolla ndjeket në Pustec)

Rrjeti i shkollave në njësinë administrative Pustec

Në Bashkinë Pustec funksionojnë gjithsej **5 institucione arsimore publike (shkolla)**, të shpërndara në zonat urbane dhe rurale, që përfshijnë:

- **4 shkolla fillore:** Shkollat fillore u shërbejnë fëmijëve në fazat e para të edukimit, duke u ofruar njohuritë bazë në lexim, shkrim, matematikë dhe lëndë të tjera themelore. Ato janë të përhapura në mënyrë të tillë që të jenë sa më pranë vendbanimeve për të siguruar akses të lehtë për nxënësit e vegjël.
- **2 shkolla 9-vjeçare:** Shkollat 9-vjeçare, gjithsej 2 në numër, përfshijnë si ciklin fillor, ashtu edhe atë të mesëm të ulët, dhe janë projektuar për të ofruar një arsim të plotë bazë. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin akademik dhe shoqëror të nxënësve dhe përgatitjen e tyre për nivelin e ardhshëm arsimor.
- **1 shkollë e mesme:** Shkolla e mesme synon të formojë të rinjtë për studime të mëtejshme universitare apo për përgatitje për tregun e punës.

Shumë prej këtyre institucioneve janë të bashkëvendosura në të njëjtën godinë me kopshtet, duke mundësuar **eficiencë në përdorimin e infrastrukturës** dhe lehtësi në akses për familjet.

Të gjitha shkollat ndodhen në territorin e Bashkisë Pustec dhe janë të klasifikuara si institucione të arsimit parauniversitar të vendosura në qendrat e banuara si Pustec, Leska,



Shulin, Tuminec dhe Dolna Gorica. Ky pozicionim i shpërndarë pasqyron përpjekjen për të mbuluar me arsim fëmijët në të gjithë njësinë administrative të bashkisë.

Aksesueshmëria

Shumica e shkollave kanë një distancë të arsyeshme nga zonat e banimit (0–5 km), megjithatë mungojnë të dhënat për aksesin e sigurt për këmbësorë, sinjalistikën dhe ndriçimin rrugor në hyrje të shkollave, çka nënvizon nevojën për përmirësim të infrastrukturës së jashtme për rritjen e sigurisë së nxënësve.

Frekuentimi

Frekuentimi në Arsimin fillor (klasat 1–5): Nxënës të regjistruar: **34** (21 djem – 61.5%, 13 vajza – 38.5%)

Frekuentimi në Arsimin 9-vjeçar (klasat 1–9): Nxënës të regjistruar: **35** (21 djem – 60%, 14 vajza – 40%). Frekuentimi është i qëndrueshëm, por tregon gjithashtu nevojën për **monitorim të vazhdueshëm, sidomos për vajzat**.

Frekuentimi në Arsimin e mesëm: Nxënës të regjistruar: **11** (4 djem – 36.4%, 7 vajza – 63.6%)

Kapaciteti dhe mobilimi

Pjesa më e madhe e shkollave kanë sipërfaqe funksionale, ndërtesa të përmasave mesatare dhe një numër klasash të kufizuar. Përdorimi i klasave dhe mobilimi me karrige dhe banka mbetet në disa raste i paplotë. Tualetet dhe lavamanët janë shpesh në numër të ulët, duke ndikuar në higjienën dhe mirëqenien e nxënësve.

Nevojat për investime

Disa shkolla kanë nevojë të drejtpërdrejtë për rikonstrukcion, sidomos në drejtim të tualeteve të përshtatshme për grup-moshën dhe mobilimit të brendshëm. Kërkohen investime në pajisje didaktike, laboratorike dhe teknologjike (kompjuterë, projektorë, pajisje për mësim të asistuar), ndërsa disa shkolla janë aktualisht në proces rikonstrukcioni.

Shërbimet bazë dhe siguria

Shërbimet themelore si furnizimi me ujë të pijshëm, energji elektrike dhe ngrohje janë të pranishme në shkolla, por jo të standardizuara. Interneti dhe telefoni mungojnë në shumicën e shkollave. Furnizimi me artikuj higjienikë (letër, sapun, dezinfektues) nuk është i garantuar në mënyrë të qëndrueshme.



Përfshirja sociale

Në disa shkolla është evidentuar prania e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe raste të veçuara të fëmijëve që nuk janë të regjistruar. Rastet e fëmijëve në situatë rruge apo me asistencë sociale janë të pakta, por raportimi i mungesave dhe arsyeve mbetet jo i plotë. Kjo evidenton nevojën për monitorim më të mirë dhe shërbime mbështetëse psiko-sociale.

Qeverisja në shkolla

Disa shkolla kanë borde të institucionalizuara që përfshijnë përfaqësues të prindërve, stafit pedagogjik, pushtetit vendor dhe nxënësve. Bordi mbledhet çdo 3 muaj.

Rrjeti i kopshteve në njësinë administrative Pustec

Aktualisht janë funksionale **5 kopshte** publike, që ofrojnë edukim dhe kujdes për fëmijët 3–6 vjeç. Ato janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të garantojnë **akses të barabartë** edhe në zonat më të thella.

Lista e kopshteve:

- Kopshti Pustec
- Kopshti Dolna Gorica
- Kopshti Tuminec
- Kopshti Leska
- Kopshti Shulin

Aksesueshmëria

Rrjeti i kopshteve në Bashkinë Pustec mbulon zonat kryesore të territorit, por përballlet me sfida të mëdha në infrastrukturë, staf, pajisje dhe standardet e mjedisit. Përmirësimi i kushteve të godinave, sigurimi i stafit të mjaftueshëm dhe pajisjeve didaktike, si dhe garantimi i shërbimeve bazë për fëmijët janë prioritetet urgjente për të siguruar edukim cilësor dhe të sigurt në fëmijërinë e hershme.

Frekuentimi në Arsimin Parashkollor (3–6 vjeç)

Në total, në këto kopshte janë të regjistruar 21 fëmijë, me shtrirje të ndryshme nga 7 fëmijë në Pustec deri në 2 fëmijë në Leska dhe Shulin.

- Numri total i fëmijëve: **21** (10 djem, 11 vajza)
- **Përfshirja: 100%** e fëmijëve ndjekin institucionet parashkollore



Burimet njerëzore

Numri i edukatoreve është i kufizuar bazuar në numrin e fëmijëve, me shumicën e kopshteve që kanë 1–2 edukatore, ndërsa vetëm një kopsht raporton praninë e një ndihmëse edukatoreje.

Infrastruktura dhe sipërfaqet

Sipërfaqja e përgjithshme e pronës së kopshteve varion nga 613 m² (Leska) deri në 3000 m² (Dolna Gorica), ndërsa ndërtesat kanë sipërfaqe që lëvizin nga 100 m² në Pustec deri në 500 m² në Tuminec.

Nevojat për rikonstrukcion dhe pajisje

Të gjitha kopshtet paraqesin nevojë për rikonstrukcion, kryesisht në drejtim të infrastrukturës sanitare. Disa kopshte si Leska dhe Shulin kanë nevojë edhe për ndërhyrje më të gjera infrastrukturore. Kjo tregon një sfidë të rëndësishme për sigurinë dhe higjienën e ambienteve që frekuentohen nga fëmijët.

10.6 Shërbimet Psiko-Sociale në Shkollë

Po, në Bashkinë Pustec ofrohen Shërbimet Psiko-Sociale në shkollë, në përputhje me politikat kombëtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Që prej disa vitesh, Ministria ka ndërmarrë hapa konkretë për të siguruar prani të punonjësve psiko-socialë (psikologë dhe punonjës socialë) në të gjitha shkollat e vendit, përfshirë edhe ato në zonat rurale dhe më të izoluar si Bashkia Pustec. Këto shërbime ofrohen për të mbështetur nxënësit në aspektin emocional, psikologjik, social dhe për të trajtuar raste të sjelljes problematike, dhunës në shkollë, apo nevoja të veçanta zhvillimore.

Në varësi të burimeve njerëzore të disponueshme, punonjësit psiko-socialë mund të jenë të përhershëm në disa shkolla ose të ndajnë kohën mes disa institucioneve.

10.7 Masat lehtësuese të Bashkisë për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

Bashkia Pustec, në bashkëpunim me shërbimet sociale, institucionet arsimore dhe strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijëve, ka ndërmarrë disa masa lehtësuese për të garantuar mbrojtjen, mirëqenien dhe përkujdesjen e fëmijëve në nevojë. Këto masa përfshijnë:

1. Mbështetje me ndihmë ekonomike



- Fëmijët në familje që përfitojnë ndihmë ekonomike trajtohen me prioritet, duke siguruar akses në shërbime bazë dhe duke mbështetur familjet për të shmangur braktisjen apo neglizhencën.

2. Shërbime psiko-sociale në shkolla

- Nëpërmjet bashkëpunimit me strukturat arsimore, fëmijët në vështirësi përfitojnë mbështetje nga psikologët dhe punonjësit socialë, për të parandaluar sjelljet problematike, dhunën, ose për të ofruar ndihmë në raste abuzimi apo trauma.

3. Bashkëpunimi me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF)

- Bashkia ka funksionalizuar Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve, e cila identifikon rastet në risk dhe ndërhyr me plane individuale për mbrojtjen e tyre, në bashkëpunim me institucionet përkatëse.

4. Ndihmë për pajisje shkollore

- Fëmijëve nga familje në nevojë u ofrohet herë pas here mbështetje me mjete shkollore, libra, fletore etj.

5. Reagim në raste urgjente

- Në rastet e dhunës, neglizhencës apo abuzimit, Bashkia, përmes NJMF dhe shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës, koordinon ndërhyrjen me strukturat e rendit, shëndetësisë dhe drejtësisë

11. Familjet rome dhe egjiptiane

Në territorin e Bashkisë Pustec nuk është e evidentuar prania e komunitetit rom apo egjiptian. Kjo dëshmohet si nga të dhënat administrative vendore, ashtu edhe nga evidencat e institucioneve publike dhe shërbimeve sociale. Si rrjedhojë, nuk janë planifikuar masa apo shërbime të dedikuara për këto komunitete në Planin Social.

12. Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale

12.1 Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale sipas njësive administrative

Sipas të dhënave të raportuara nga Bashkia Pustec:

- Nuk është regjistruar asnjë kërkesë nga të moshuarit për shërbime familjare, qendra ditore, strehim social apo shërbime rezidenciale.
- 10 të moshuar rezultojnë përfitues të skemës së ndihmës ekonomike, çka tregon se janë të identifikuar nga sistemi si pjesë e familjeve me vështirësi ekonomike.

- 6 femra - 4 meshkuj



-
-
-
-

Megjithëse kërkesat e shprehura janë formalisht zero, kjo nuk përjashton ekzistencën e nevojës reale për shërbime sociale, por mund të reflektojë:

- mungesën e informimit të të moshuarve mbi të drejtat dhe shërbimet e mundshme,
- barrierat kulturore dhe sociale në kërkimin e ndihmës,
- mungesën e strukturave konkrete në territor për të ofruar këto shërbime.

12.2 Shërbimet e kujdesit shoqëror për të moshuarit

Bashkia Pustec ka ofruar mbështetje të herëpashershme për personat e moshuar dhe familjet në nevojë, përmes shpërndarjes së pakove ushqimore, në raste të identifikuara apo në periudha të veçanta si festa, stina e dimrit apo raste emergjente sociale.

Gjithashtu, një shërbim i rëndësishëm që ofrohet në mënyrë të vazhdueshme nga Bashkia është vënia në dispozicion e një mjeti ambulance, për transportin dhe ndihmën e menjëhershme të të moshuarve apo çdo familjeje në nevojë që ka urgjencë mjekësore ose vështirësi në aksesimin e shërbimeve shëndetësore.

Këto ndërhyrje, ndonëse të kufizuara në burime, reflektojnë përpjekjet e bashkisë për të mbështetur shtresat vulnerabël, në mungesë të një strukture të dedikuar për përkujdesjen e të moshuarve.

13. Personat me varësi nga droga dhe nga alkooli

13.1 Identifikimi i rasteve me varësi nga substancat

Identifikimi i rasteve me varësi nga substancat si droga dhe alkooli kryhet përmes bashkëpunimit ndërinstitutional, duke përfshirë:

- Institutionet shëndetësore, të cilat evidentojnë raste përmes kontakteve të drejtpërdrejta me individët gjatë konsultave mjekësore ose urgjencave.
- Shërbimet sociale, të cilat marrin sinjalizime nga komuniteti, familjarë apo organizata të shoqërisë civile.
- Fushatat e sensibilizimit dhe ndërgjegjësimin në komunitet, të cilat ndihmojnë në zbulimin e rasteve të fshehura dhe nxitjen për të kërkuar ndihmë.
- Policia, përmes ndërhyrjeve në raste të dhunës në familje, ngjarjeve në gjendje të dehur apo incidenteve me natyrë penale.



13.2 Numri i rasteve të raportuara

Sipas të dhënave zyrtare:

- Numri i rasteve të identifikuara dhe të raportuara nga Policia të personave me varësi nga droga: 0
- Numri i rasteve të identifikuara dhe të raportuara nga Policia të personave me varësi nga alkooli: 0

Kjo tregon se nuk janë identifikuar raste zyrtarisht të raportuara nga Policia në territorin e Bashkisë Pustec për vitin përkatës. Megjithatë, mungesa e rasteve të raportuara nuk përjashton ekzistencën e problematikës, por mund të sinjalizojë:

- Mungesë mekanizmash të mirëfunksionuar për identifikimin dhe referimin e rasteve në nivel vendor;
- Mungesë ndërgjegjësimi në komunitet për të raportuar raste të tilla;
- Stigmatizim apo frikë nga ekspozimi publik i individëve dhe familjeve që përballen me këtë problem.

14. Migrantët dhe Emigrantët

Migrimi dhe emigrimi janë fenomene të theksuara në Bashkinë e Pustecit, një zonë e njohur për shumicën e saj maqedonase dhe për lidhjet e forta me diasporën, veçanërisht në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut. Këto dukuri kanë ndikim të drejtpërdrejtë në strukturën demografike, ekonominë dhe identitetin kulturor të rajonit.

Migrimi dhe Emigrimi në Pustec

- **Emigrimi i brendshëm dhe jashtë vendit:** Nga vitet 1990, Pusteci ka pësuar një rënie të konsiderueshme të popullsisë. Sipas të dhënave të vitit 2023, bashkia ka vetëm 1,843 banorë, duke e bërë atë bashkinë më të vogël në Shqipëri. Ky rënie është pasojë e emigrimit të vazhdueshëm drejt vendeve si Greqia, Maqedonia e Veriut dhe shtetet e tjera të BE-së.
- **Diaspora dhe lidhjet kulturore:** Shumë banorë të Pustecit kanë emigrantë të afërm në Greqi dhe Maqedoni, të cilët ndihmojnë financiarisht dhe shpesh dërgojnë barna përmes postës ose përmes mjekëve që udhëtojnë nga Korça. Ky fenomen ka ndikuar në mbylljen e farmacive lokale, duke i detyruar banorët të udhëtojnë deri në Korçë për të blerë medikamente.



15. Shërbimet Bazë që ofron Bashkia Pustec

1. Shërbime për fëmijët dhe familjet

- Identifikimi dhe menaxhimi i rasteve të rrezikut për fëmijët (në përputhje me Ligjin 18/2017)
- Mbështetje psiko-sociale për fëmijë dhe prindër
- Përfshirje në procesin e mbrojtjes dhe edukimit të hershëm

2. Shërbime për personat me aftësi të kufizuara (PAK)

Transport dhe akses fizik

- Megjithëse infrastruktura në zonat rurale paraqet vështirësi, Bashkia ka për qëllim të **lehtësojë transportin** për PAK në raste mjekësore, përfitime sociale apo pjesëmarrje në veprimtari komunitare.

Trajtimi me Ndhimë Ekonomike dhe Pagesë të AAK-së

- Personat me aftësi të kufizuara përfitojnë pagesën e Aftësisë së Kufizuar dhe të kujdestarisë (ku aplikohet), në përputhje me vlerësimet mjekësore dhe aktet ligjore në fuqi.
- PAK mund të jenë gjithashtu përfitues të ndihmës ekonomike, në rastet kur plotësojnë kriteret e skemës.

3. Shërbime për të moshuarit

Bashkia Pustec, duke njohur rëndësinë e përkujdesjes ndaj moshës së tretë, ofron disa forma mbështetjeje për të moshuarit që jetojnë në territorin e saj. Këto shërbime janë kryesisht në funksion të mirëqenies sociale, përkujdesjes në komunitet dhe lehtësimit të jetesës për të moshuarit pa përkrahje.

Ndihma ekonomike dhe asistencë sociale



- Të moshuarit që jetojnë vetëm dhe nuk përfitojnë nga skema të tjera mbështetjeje, mund të përfshihen në **skemën e ndihmës ekonomike**, në varësi të vlerësimit të gjendjes së tyre ekonomike dhe sociale.
- Bashkia ofron **mbështetje me ndihma ushqimore apo ndihma emergjente**, veçanërisht gjatë dimrit ose në raste të fatkeqësive natyrore.

4. Shërbime për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore

- Shërbime të menjëhershme mbështetëse (psikolog, jurist, transport)
- Këshillim për rindërtim të jetës dhe pavarësi ekonomike
- Koordinimi i rasteve përmes mekanizmit të referimit

5. Shërbime për persona në situatë rreziku social

Bashkia Pustec, përmes strukturave të saj sociale dhe në bashkëpunim me institucione shtetërore dhe organizata partnere, ofron një sërë **shërbimesh dhe masash mbështetëse** për individët dhe familjet që gjenden në situatë rreziku social. Kjo përfshin fëmijët, gratë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, si dhe familjet në kushte ekstreme varfërie apo përjashtimi.

Përkrahja për Viktimat e Dhunës në Familje

- Për rastet e dhunës në familje, punonjësit e shërbimit social të Bashkisë ndërhyjnë për të **identifikuar viktimat**, për të ofruar **ndihmë psiko-sociale**, si dhe **mbështetje emocionale**.

Ndihmë Ekonomike dhe Mbështetje Materiale

- Familjet dhe individët në nevojë përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga ligji.
- Në raste urgjente ose të jashtëzakonshme, Bashkia ofron ndihma në natyrë, si ushqime, medikamente bazë, ose ndihmë për përballimin e dimrit.

6. Shërbime të koordinimit dhe menaxhimit të rasteve

Bashkia Pustec, nëpërmjet strukturave të saj të shërbimeve sociale, ofron funksione të rëndësishme për identifikimin, menaxhimin dhe ndjekjen e rasteve sociale, veçanërisht për individët dhe familjet në situatë rreziku apo përjashtimi social.

- Bashkia ka në funksion Mekanizmin e Referimit për rastet e dhunës në familje dhe të tjera situata të ndërlikuara sociale.
- Punonjësit e shërbimeve sociale punojnë me institucione të tjera (shëndetësi, arsim, rend, gjykata, OJF) për të ofruar ndërhyrje të koordinuara dhe gjithëpërfshirëse.



Shërbimet Sociale Funksionale në Bashkinë Pustec

Nr.	Shërbimi	Është funksional?	Komente
1	Ndihmë Ekonomike për familjet në nevojë	✓ Po	Ofruar sipas skemës kombëtare, përmes Sektorit të Ndihmës Ekonomike
2	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF)	✓ Po	Njësi funksionale që menaxhon rastet e fëmijëve në rrezik
3	Shërbime për PAK (persona me aftësi të kufizuara)	✓ Po	Mbështetje me ndihmë ekonomike, referim për shërbime
4	Ndihmë në banesë për persona të moshuar pa përkrahje	✓ Po	Ofrim asistence në raste të veçanta, ndihme ekonomike
5	Shërbime për menaxhimin e rasteve sociale	✓ Po	Përmes vlerësimit dhe bashkëpunimit ndër-institucional
6	Mekanizmi i Referimit për Dhunën në Familje	✓ Po	Funksional në bashkëpunim me institucionet përkatëse

16. Kapacitetet e bashkisë

1. Kapacitetet Institucionale dhe Organizative

- **Struktura e Shërbimeve Sociale** funksionon në nivel bashkie përmes:
 - Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale;
 - Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF);
 - Punonjësit të shërbimit social dhe punonjësve administrativë të njësive administrative.
- Bashkia ka një **strukturë të vogël por funksionale**, që përpiqet të përmbushë detyrimet ligjore bazë për mirëqenie sociale.



2. Burimet Njerëzore

- Numri i **punonjësve socialë** është i kufizuar, shpesh me mbulim të shumë funksioneve njëkohësisht.
- **NJMF është funksionale**, por me kapacitet minimal.
- Stafi shpesh përballët me mungesë formimi të vazhdueshëm profesional dhe nevojë për përforsim me **specialistë psiko-socialë**.

3. Burimet Financiare

- Burimet financiare për shërbime sociale janë të kufizuara, të përqendruara kryesisht në:
 - Ndihmën ekonomike;
 - Mbështetje për raste të veçanta përmes fondit rezervë;
 - Projekte të mundshme me financim të jashtëm (në bashkëpunim me donatorë ose OJF).
- Mungon një **linjë buxhetore e dedikuar** për shërbime të reja si qendrat ditore etj.

4. Kapaciteti për Koordinim Ndërinstitucional

- Bashkia është pjesë e **mekanizmave të referimit** për dhunën në familje dhe mbrojtjen e fëmijëve.
- Ka një nivel të **moderuar bashkëpunimi** me shkollat, qendrat shëndetësore, policinë dhe organizatat civile.
- Koordinimi shpesh ndikohet nga mungesa e logjistikës dhe strukturave të përbashkëta.

5. Infrastrukturë dhe Hapësira Fizike

- **Nuk ka qendra ditore** për PAK apo të moshuar;
- **Nuk ka hapësira të dedikuara** për aktivitete psiko-sociale, qendra komunitare apo rehabilituese.

6. Kapaciteti për të Aplikuar në Projekte dhe Partneritete

- Bashkia ka **përvojë të kufizuar në hartimin dhe menaxhimin e projekteve** sociale me donatorë apo programe të BE.
- Ka potencial për zhvillim të kapaciteteve në këtë drejtim përmes partneriteteve me OJF-të dhe agjenci zhvillimi.

Bashkia Pustec zotëron **kapacitete themelore për ofrimin e shërbimeve sociale bazë**, por ka nevojë të theksuar për:

- Zgjerimin e burimeve njerëzore dhe profesionale,
- Krijimin e infrastrukturës sociale,
- Rritjen e kapacitetit institucional për projektim dhe bashkëpunim ndërsektorial.



17. Vizioni dhe Misioni

Vizioni

Të garantohet akses i barabartë, gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm në shërbimet sociale për çdo qytetar në territorin e Bashkisë Kolonjë, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës, uljen e përjashtimit social dhe fuqizimin e grupeve në nevojë, në përputhje me vlerat komunitare, realitetin lokal dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

Misioni

Bashkia Kolonjë, përmes zbatimit të Planit Vendor Social, angazhohet të zhvillojë dhe ofrojë politika dhe shërbime sociale efektive, të integruara dhe të orientuara drejt nevojave reale të komunitetit, duke vendosur në qendër qytetarin, fuqizimin e grupeve vulnerabël, bashkëpunimin ndërinstitutional dhe përfshirjen aktive të aktorëve vendorë e partnerëve socialë, në funksion të një sistemi social gjithëpërfshirës, të drejtë dhe reagues.

18. Qëllimet dhe Objektivat

QËLLIMI 1: Zbutja e varfërisë dhe përmirësimi i kushteve të jetesës për individët dhe familjet në nevojë, me fokus të veçantë tek personat me aftësi të kufizuara, përmes ofrimit të ndihmës ekonomike dhe përfitimeve të tjera sociale në mënyrë të drejtë, transparente, të ndjeshme ndaj gjinisë dhe të përshtatshme për t'u përballur me situata krizash apo emergjencash.

- **Objektivi 1.1:** Përmirësimi i riintegritit social dhe ekonomik të individëve përfitues të ndihmës ekonomike, përmes referimit aktiv drejt punësimit, formimit profesional dhe nxitjes së ndërmarrjeve sociale në nivel vendor.
- **Objektivi 1.2:** Rritja e kapaciteteve të bashkisë për t'iu përgjigjur në kohë dhe në mënyrë të drejtë nevojave të individëve dhe familjeve vulnerabël, përmes ofrimit të ndihmës ekonomike dhe përfitimeve financiare në situata krizash dhe emergjencash.
- **Objektivi 1.3:** Përmirësimi i aksesit dhe përfshirjes sociale të personave me aftësi të kufizuara në jetën publike dhe komunitare, përmes ofrimit të shërbimeve sociale dhe mbështetëse të përshtatshme, të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse nga strukturat vendore.



- **Objektivi 1.4:** Rritja e mbështetjes për të moshuarit në nevojë përmes shërbimeve sociale dhe komunitare të qëndrueshme, të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse.

QËLLIMI 2: Parandalimi dhe eliminimi i të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit dhe praktikave të dëmshme, përmes një qasjeje të koordinuar, parandaluese dhe gjithëpërfshirëse.

- **Objektivi 2.1:** Fëmijët rriten në një mjedis mbështetës, me praktika pozitive të prindërimit, që i mbrojnë nga dhuna dhe abuzimi.
- **Objektivi 2.2:** Funksionimi efektiv i një sistemi vendor të mbrojtjes së fëmijëve, gjithëpërfshirës, i koordinuar dhe i dobishëm për identifikimin, referimin dhe ndjekjen e rasteve të riskut.
- **Objektivi 2.3:** Parandalim i dhunës në familje, rehabilitim dhe fuqizim për viktimat e dhunës
- **Objektivi 2.4:** Përmirësimi i cilësisë, efektivitetit dhe përshtatshmërisë së shërbimeve komunitare sociale në nivel vendor, në përputhje me standardet kombëtare dhe nevojat e grupeve në situatë vulnerabilitet.

19. Plani i Veprimit

QËLLIMI 1: Zbutja e varfërisë dhe përmirësimi i kushteve të jetesës për individët dhe familjet në nevojë, me fokus të veçantë tek personat me aftësi të kufizuara, përmes ofrimit të ndihmës ekonomike dhe përfitimeve të tjera sociale në mënyrë të drejtë, transparente, të ndjeshme ndaj gjinisë dhe të përshtatshme për t'u përballur me situata krizash apo emergjencash.

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	INDIKATORË	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
<i>Objektivi 1.1: Përmirësimi i riintegritit social dhe ekonomik të individëve përfitues të ndihmës ekonomike, përmes referimit aktiv drejt punësimit, formimit profesional dhe nxitjes së ndërmarrjeve sociale në nivel vendor.</i>						
A1.1.1 Nxitja, lehtësimi dhe mbështetja e të rinjve (vajza dhe djem, nga zonat rurale dhe urbane) nga familjet përfituese të ndihmës ekonomike për arsim, formim, këshillim dhe punësim, përmes identifikimit dhe referimit të tyre. (lidhja me garancinë rinore);	Spektori i Ndihtmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, AKPA, SHSSH	2026 2027 2028	Numri i të rinjve (vajza dhe djem) përfitues të ndihmës ekonomike që janë identifikuar dhe referuar nga bashkia drejt shërbimeve të arsimit, formimit profesional, këshillimit apo punësimit.	Bashkia, parteritet me dhe AKPA dhe SHSSH	0	Spektori i Ndihtmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale
A1.1.2 Zhvillimi dhe zbatimi nga bashkia i formave të mbështetjes për punësim dhe vetëpunësim të përfituesve të ndihmës ekonomike në	Spektori i Ndihtmës Ekonomike dhe Shërbimeve	2027 2028	Numri i përfituesve të ndihmës ekonomike në moshë pune që	Bashkia, parteritet me dhe AKPA dhe SHSSH	0	Spektori i Ndihtmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale

moshë pune, veçanërisht në zonat rurale, me qëllim daljen graduale nga skema; me fokus të veçantë tek gratë dhe vajzat, prindërit e vetëm dhe nënat kryefamiljare, për të reduktuar barrën e punës së papaguar dhe të kujdesit.	Sociale, AKPA, SHSSH	janë referuar drejt masave për punësim, formim ose vetëpunësim. (gra/burra) Numri i grave dhe vajzave përfituese të NE që janë përfshirë në skema punësimi ose vetëpunësimi. Numri i nënave kryefamiljare dhe prindërve të vetëm që kanë dalë nga skema si rezultat i përfshirjes në punësim ose ndërmarrje të vogla. Numri i masave mbështetëse të ndërmarra nga bashkia (trajtime, grante të vogla, partneritete me			
--	-----------------------------	---	--	--	--

			OJF/OShC) për punësim të përfituesve të NE.			
A1.1.3. Organizimi i fushatave lokale të ndërgjegjësimit, në bashkëpunim me Zyrat e Punës dhe partnerë të tjerë, për të informuar komunitetin – veçanërisht grupet në nevojë (gra, të rinj, PAK, prindër të vetëm) – mbi mundësitë e punësimit, formimit profesional dhe afatet e mbështetjes.	Spektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, AKPA, SHSSH	2026 2027 2028	Numri i fushatave të ndërgjegjësimit të organizuara nga bashkia në bashkëpunim me Zyrën e Punës dhe/ose partnerë të tjerë lokalë. Numri i pjesëmarrësve në fushata, të ndarë sipas gjinisë dhe grupeve të targetuara (gra/vajza, të rinj, PAK, prindër të vetëm). Numri i referimeve të bëra pas fushatave drejt shërbimeve të punësimit ose	Bashkia, parteritet me dhe AKPA SHSSH	0	Spektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale

			formimit profesional. Përqindja e fushatave të realizuara në zonat rurale nga total fushatave. Numri i materialeve informuese të shpërndara (fletëpalosje, posterë, njoftime dixhitale).			
A1.1.4 : Rritja e kapaciteteve të personelit të sektorit të shërbimeve sociale në nivel vendor	Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Partneritet me organizata joqeveritare	2026 2027 2028	Numri i aktiviteteve të trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve të realizuara për stafin e shërbimeve sociale të bashkisë. Numri i punonjësve të përfshirë në trajnim (administratorë,	Bashkia, OJF, Donatorë	0	Zv.Kryetari

			punonjës NJVRN, punonjës të mbrojtjes së fëmijës, etj.). Përqindja e stafit të sektorit të shërbimeve sociale që kanë marrë pjesë në të paktën një aktivitet formimi gjatë vitit. Numri i moduleve tematike të trajtuara (vlerësim i nevojave, ndjeshmëri gjinore, menaxhim rastesh, etj.). Përqindja e pjesëmarrësve që raportojnë përmirësim të njohurive pas			
--	--	--	---	--	--	--

			përfundimit të trajnimit.			
A1.1.5. Rishikimi periodik i Planit Social	Spektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Buxhetit	2026 2027 2028	Numri i rishikimeve zyrtare të Planit Social të realizuara gjatë periudhës 3-vjeçare. Numri i raporteve të monitorimit dhe zbatimit të Planit Social të përgatitura nga bashkia. Përqindja e masave të Planit Social të vlerësuara nëpërmjet monitorimit dhe rishikimit. Numri i konsultimeve të organizuara me aktorë lokalë dhe komunitetin për rishikimin e Planit.	Bashkia	0	Zv.Kryetari

			Numri i masave të përmirësuara, shtuar ose përshtatur në Plan pas rishikimit.			
<i>Objektivi 1.2: Rritja e kapaciteteve të bashkisë për t'iu përgjigjur në kohë dhe në mënyrë të drejtë nevojave të individëve dhe familjeve vulnerabël, përmes ofrimit të ndihmës ekonomike.</i>						

A1.2.1. Themelimi i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit	Spektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Burimeve Njerëzore	2026	NJVNR e organizuar në numër dhe funksione sipas parashikimeve ligjore;	0	Zv.Kryetari
A1.2.2. Rritja e kapaciteteve të stafit të bashkisë për menaxhimin e rasteve emergjente sociale, përmes trajnimeve të dedikuara dhe krijimit të një databaze vendore për personelin e trajnuar.	Spektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, Spektori i Emergjencave Civile	2027 2028	Numri i trajnimeve të organizuara për personelin e bashkisë mbi menaxhimin e rasteve emergjente sociale. Numri i punonjësve të shërbimeve sociale që kanë marrë pjesë në trajnimet për emergjencat. Përqindja e stafit të spektorit të shërbimeve sociale të trajnuar për reagimin në situata emergjente. Ekzistenca e një databaze funksionale dhe të përditësuar të personelit të trajnuar për raste emergjente. Numri i përditësimeve të databazës së personelit të trajnuar të realizuara nga bashkia gjatë periudhës së Planit.	0	Zv.Kryetari

A1.2.3: Funksionalizimi i një fondi emergjence sociale në nivel vendor, për të përballuar situata të paparashikuara që prekin familjet dhe individët në nevojë.	Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale,	2026- 2027 2028	Ekzistenca e një fondi të dedikuar për emergjencat sociale në buxhetin vendor Numri i rasteve të mbështetura nga fondi emergjent	1,000,000/vit → 3,000,000	Zv.Kryetari
---	---	-----------------------	---	------------------------------	-------------

Objektivi 1.3:Përmirësimi i aksesit dhe përfshirjes sociale të personave me aftësi të kufizuara në jetën publike dhe komunitare, përmes ofrimit të shërbimeve sociale dhe mbështetëse të përshtatshme, të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse nga strukturat vendore.

A1.3.1. Rritja e kapaciteteve të strukturave vendore për zbatimin e reformës së vlerësimit biopsiko-social të personave me aftësi të kufizuara, përmes forcimit të burimeve njerëzore, trajnimeve për miradministrim dhe ndërtimit të mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit në nivel vendor.	Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, SHSSH	2027 2028	Numri i punonjësve të përfshirë në strukturat e vlerësimit biopsiko-social që janë trajnuar nga bashkia. Ekzistenca e një strukture funksionale të vlerësimit biopsiko-social në bashki. Numri i vlerësimeve biopsiko-sociale të	Bashkia, parteritet me SHSSH	0	Zv. Kryetari
--	--	--------------	--	------------------------------------	---	-----------------

			kryera nga strukturat e bashkisë gjatë vitit. Numri i mekanizmave të monitorimit të procesit të vlerësimit të ngritur në bashki (formularë, raporte, takime koordinimi). Përqindja e rasteve të vlerësuara që janë ndjekur me plan shërbimi dhe referim të mëtejshëm.			
A1.3.2. Zgjerimi dhe përmirësimi i mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara (PAK) në nivel vendor, përmes ofrimit dhe lehtësimit të aksesit në shërbime shoqërore, shëndetësore, arsimore, si dhe programe të formimit të aftësive për jetesë të pavarur dhe punësim.	Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, SHSSH, AKPA, DAR, OSHKSH	2027 2028	Numri i PAK-ve që kanë përfituar shërbime të mbështetjes përmes strukturave të bashkisë (sociale, shëndetësore, arsimore, formim/punësim). Numri i llojeve të shërbimeve mbështetëse të ofruara për PAK në	Bashkia, parteritet me SHSSH, AKPA, DAR, OSHKSH	0	Zv. Kryetari

			territorin e bashkisë. Përqindja e PAK-ve të identifikuar nga bashkia që janë lidhur me të paktën një shërbim mbështetës. Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione publike ose OJF për ofrimin e shërbimeve për PAK. Numri i rasteve të PAK-ve që kanë përfituar mbështetje për përfshirje në arsim ose formim profesional.			
A1.3.3. Forcimi i Mekanizmit Vendor të Referimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK), përmes menaxhimit të integruar të rasteve nga ekipe multidisciplinare, krijimit të profileve individuale të PAK, dhe zbatimit të protokolleve për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale, me fokus të veçantë tek gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara që përballen me dhunë gjinore.	Spektori i Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, AKPA, SHSSH	2026 2027 2028	Numri i rasteve të PAK-ve të trajtuara nga Mekanizmi Vendor i Referimit përmes menaxhimit të integruar të rastit.	Bashkia, parteritet me SHSSH, AKPA, DAR, OSHKSH	0	Zv. Kryetari

			Numri i profileve individuale të PAK-ve të krijuara dhe të pasuruara nga ekipet multidisiplinare. Numri i protokolleve të miratuara dhe të zbatuara për rastet e PAK, përfshirë mbrojtjen nga dhuna. Numri i rasteve të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara të identifikuara si viktime të dhunës që kanë përfituar ndërhyrje të koordinuara për mbrojtje dhe mbështetje. Numri i takimeve funksionale të Mekanizmit të Referimit për menaxhimin e rasteve të PAK.			
--	--	--	---	--	--	--

Objektivi 1.4: Rritja e mbështetjes për të moshuarit në nevojë përmes shërbimeve sociale dhe komunitare të qëndrueshme, të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse.

A 1.4.1: Ofrimi i shërbimeve të përkujdesjes në shtëpi për të moshuarit e vetmuar dhe në pamundësi fizike	Spektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, partneritet me OJF apo qendra shëndetësore.	2027 2028	Numri i të moshuarve përfitues / numri i vizitave mujore / % e rasteve të ndjekura rregullisht.	Bashkia	0	Zv. Kryetari
A 1.4.2: Krijimi i hapësirave komunitare për të moshuarit në çdo njësi administrative (kënd social)	Spektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, partneritet me OJF	2027 2028	Numri i hapësirave funksionale / numri i pjesëmarrësve në muaj.	Bashkia	0	Zv. Kryetari
A 1.4.3: Fushata ndërgjegjësimi për mbështetjen e të moshuarve nga komuniteti dhe familja, nëpërmjet shkollave, qendrave komunitare, rrjeteve të rinjve, etj.Fokus: edukimi ndërbreznor dhe rritja e ndjeshmërisë sociale.	Spektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale	2026 2027 2028	Numri i fushatave / materialeve informuese / pjesëmarrësve të angazhuar.	Bashkia	0	Zv. Kryetari

QËLLIMI 2: Parandalimi dhe eliminimi i të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit dhe praktikave të dëmshme, përmes një qasjeje të koordinuar, parandaluese dhe gjithëpërfshirëse.

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
Objektivi 2.1 Fëmijët rriten në një mjedis mbështetës, me praktika pozitive të prindërimit, që i mbrojnë nga dhuna dhe abuzimi.						
A.2.1.1. Hartimi dhe zbatimi i një plani vendor të komunikimit dhe ndërgjegjësimit, i shoqëruar me materiale informuese dhe edukuese, për të adresuar normat dhe sjelljet negative që lidhen me dhunën dhe abuzimin ndaj fëmijëve, duke përfshirë edhe çështjen e martesave të hershme.	Spektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, partnerë	2026 2027	Plani i komunikimit i përgatitur dhe miratuar nga bashkia. Numri i produkteve me mesazhe sensibilizuese të përgatitura dhe shpërndara. Numri i personave të informuar ose të përfshirë në aktivitetet e ndërgjegjësimit.	Bashkia	0	Zv.Kryetari
A.2.1.2 Zhvillimi dhe zbatimi i trajnimeve mbi prindërimin pozitiv, të përshtatura për përdorim nga profesionistët vendorë, përfshirë punonjësit e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve , si dhe profesionistët e qendrave komunitare.	Spektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale	2026 2027	Numri i prindërve të këshilluar mbi prindërimin pozitiv, përfshirë ata me aftësi të kufizuara	Bashkia	0	Zv.Kryetari

Trajnimet synojnë fuqizimin e aftësive për mbështetjen e prindërve në funksion të mirëqenies dhe mbrojtjes së fëmijëve.						
A.2.1.3 Zhvillimi i ndërhyrjeve për ndërgjegjësimin e komunitetit shkollor dhe mbështetjen e krijimit të një kulture gjithëpërfshirëse dhe pozitive, që refuzon dhunën, bulizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, në bashkëpunim me institucionet arsimore dhe aktorët lokalë.	Spektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale	2026 2027 2028	Veprimtari ndërgjegjësimi	Bashkia + Shkolla	1,000,000/vit → 3,000,000	Spektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale
Objektivi 2.2: Funksionimi efektiv i një sistemi vendor të mbrojtjes së fëmijëve, gjithëpërfshirës, i koordinuar dhe i dobishëm për identifikimin, referimin dhe ndjekjen e rasteve të riskut.						
A.2.2.1 Ngritja e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në NJVV në bazë të moduleve të certifikuara dhe aprovuara për menaxhimin e rasteve me qasje ndërsektorale të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.	Spektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, Partnerë,	2026	% e punonjësve të trajnuar çdo vit; Tematikat e trajnimit	Bashkia	0	Kabineti i Kryetarit

A.2.2.2 Menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje dhe referimi tek shërbimet	Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës	2026 2027 2028	Numri i rasteve të menaxhuara përmes qasjes ndërsektoriale; Numri i rasteve të fëmijëve për të cilët janë marrë masa mbrojtëse; Numri i rasteve të fëmijëve të mbështetur me shërbime; Numri i takimeve ndërsektoriale të zhvilluara; Numri i përfaqësuesve të institucioneve pjesëmarrës në takime;	Bashkia dhe çdo institucion i parashikuar në ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës	0	Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale
Aktiviteti 2.2.3 Shërbimi i këshillimit me telefon.	Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale	2026 2027 2028	Marrëveshje me linjën e Këshillimit për Fëmijë ALO 116111; Numri i rasteve të fëmijëve që kanë kërkuar dhe kanë marrë këshillim; Numri i rasteve të fëmijëve të referuar tek NJMF përmes linjës së këshillimit;	Bashkia në partneritet me Linjën e Këshillimit për Fëmijë Alo 116111	0	Kabineti i Kryetarit

Aktiviteti 2.2.4 Qendër ditore për fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike	Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, Staf i qendrës ditore;	2027 2028	Infrastruktura e godinës e përshtatëshme për ofrimin e shërbimit; Shërbimi i ngritur dhe funksional në përputhje me standartet kombëtare për shërbimin specifik; Stafet profesionale të trainuara për ofrimin e shërbimit; Numri i përfituesve të shërbimit që ofron qendra;	Fondi Social Ministria e Shëndësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia	0	Zv.Kryetari
<i>Objektivi 2.3: Parandalim i dhunës në familje, rehabilitim dhe fuqizim për viktimat e dhunës</i>						
A.2.3.1 Ngritja dhe funksionimi i mekanizmit vendor për parandalimin e dhunës në familje dhe adresimin e nevojave të viktimave të saj	Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale	2026 2027 2028	Marrëveshja e nënshkruar mes Kryetarit të Bashkisë dhe drejtuesve të institucioneve të parashikuara në legjislacionin specifik; Numri i takimeve të Komitetit Drejtues dhe çështjet e diskutuar;	Bashkia dhe çdo institucion i parashikuar në legjislacionin specifik, si dhe organizatat joqeveritare pjesë e Komitetit.	0	Kabineti i Kryetarit

			Raporte dhe analiza të përgatitura për Komitetin Drejtues; Masa të marra në vijim të takimeve të Komitetit Drejtues; Rritje e ndërgjegjësimit komunitar kundër dhunës; Reduktim i dhunës në familje;			
A.2.3.2 Menaxhimi i rasteve të dhunës në familje dhe referimi tek shërbimet	Koordinatori vendor për masa kundër dhunës në familje në partneritet me administratorët shoqëror	2026 2027 2028	Numri i rasteve të dhunës të referuara; Numri i rasteve të menaxhuara përmes qasjes multisektoriale; Numri i viktimave të dhunës të pajisura me Urdhër mbrojtje/ Urdhër të menjëhershëm mbrojtje; Numri i viktimave të dhunës që kanë marrë shërbime reabilituese/fuqizues e;	Bashkia	0	Spektori i Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale
A.2.3.3	Spektori i Ndhmës	2026 2027	Marrëveshje me linjën e Këshillimit	Bashkia	0	Kabineti i Kryetarit

Shërbimi i këshillimit me telefon	Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale	2028	për viktimat e dhunës në familje; Numri i rasteve të viktimave të dhunës që kanë kërkuar dhe kanë marrë këshillim; Numri i rasteve të viktimave të dhunës të referuara nga Linja tek koordinatori vendor për masa kundër dhunës në familje;			
A.2.3.4 Shërbimi i emergjencës 72 orë për viktimat të dhunës në familje	Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale Koordinatori vendor për masat kundër dhunës në familje	2026 2027 2028	Apartamentet funksionale për çdo rast; Staf i dedikuar dhe i trainuar për shërbim; Numri i rasteve të akomoduara në kushtet e emergjencës; Numri i rasteve që kanë përfituar shërbime rehabilituese dhe riintegruese;	Fondi Social Ministria e Shëndësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia	0	Zv.Kryetari
Objektivi 2.4: Përmirësimi i cilësisë, efektivitetit dhe përshtatshmërisë së shërbimeve komunitare sociale në nivel vendor, në përputhje me standardet kombëtare dhe nevojat e grupeve në situatë vulnerabilitet.						
A.2.4.1 Zbatimi i një procesi periodik monitorimi nga	Punonjësi social/ Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale	2026 2027 2028	Numri i monitorimeve të realizuara mbi shërbimet	Bashkia	0	Zv.Kryetari

bashkia për të vlerësuar cilësinë dhe përshtatshmërinë e shërbimeve komunitare sociale që ofrohen në territorin e saj, në përputhje me standardet kombëtare dhe nevojat e përfituesve.	Drejtoria Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror		komunitare nga bashkia. Numri i shërbimeve komunitare të vlerësuar për cilësinë dhe përshtatshmërinë. Përqindja e shërbimeve që përmbushin standardet minimale të cilësisë sipas vlerësimit të bashkisë. Numri i rekomandimeve të dalë nga procesi i monitorimit për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve. Përqindja e rekomandimeve të zbatuara brenda vitit nga ofruesit e shërbimeve. Numri i takimeve të organizuara me përfitues ose staf për të mbledhur feedback mbi shërbimet.			
--	--	--	--	--	--	--



20. Monitorimi dhe raportimi

Zbatimi i Planit Vendor të Veprimit për Planin Social 2026–2028 do të shoqërohet nga një sistem i dedikuar monitorimi dhe raportimi, i cili siguron ndjekjen në kohë reale të progresit, evidentimin e sfidave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimeve të ndërmarra. Ky sistem do të bazohet në një qasje të kombinuar: institucionale, participuese dhe të bazuar në të dhëna.

Qasja dhe parimet e monitorimit

Monitorimi do të jetë:

- **i strukturuar**, me përgjegjësi të qarta për çdo njësi zbatuese;
- **i bazuar në tregues të matshëm**, të përcaktuar për çdo aktivitet;
- **i hapur ndaj pjesëmarrjes së komunitetit dhe aktorëve jo publikë**, për të garantuar transparencën dhe përfshirjen.

Njësia e ngarkuar me monitorimin e zbatimit të aktiviteteve:

- **Spektori i Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale**, do të luajë rolin koordinues dhe teknik për grumbullimin dhe analizën e të dhënave, do të ndjekë progresin në nivel strategjik dhe do të raportojë në Këshillin Bashkiak.
- **Drejtoria dhe njësia zbatuese përkatëse** janë përgjegjëse për dërgimin periodik të informacionit mbi zbatimin e aktiviteteve.

Treguesit e matjes së performancës së shërbimeve të kujdesit shoqëror:

Për secilin aktivitet në plan janë përcaktuar tregues të qartë si: numri i trajnimeve të realizuara, numri i strukturave të ngritura, ngirtja dhe funksionalizimi i shërbimeve të reja, etj. Treguesit aty ku është e mundur paraqiten të ndarë sipas gjinisë, sipas grupmoshës dhe zonës (urbane/rurale). **Treguesit paraqiten të detajuara në planin e veprimit, për secilin aktivitet.**



Formatet e raportimit

Raportimi do të realizohet:

- **Çdo 6 muaj**, përmes një formati të thjeshtuar të mbledhjes së të dhënave dhe analizës së realizimit të planit social, që do të përdoret nga të gjitha drejtoritë dhe njësitë administrative.
- **Çdo vit**, përmes një raporti të përmbledhur vjetor mbi progresin e Planit, i cili do të publikohet në faqen e internetit të bashkisë dhe do t'u prezantohet këshilltarëve dhe komunitetit.
- Raporti vjetor do të përmbajë analiza të të dhënave, shembuj praktikë nga territori, si dhe rekomandime për përmirësim të mëtejshëm.

Mbledhja e të dhënave, analiza dhe dixhitalizimi

Brenda vitit të parë të zbatimit, do të krijohet një regjistër dixhital për monitorimin dhe publikimin e statistikave dhe progresit të planit. Ky informacion do të jetë e hapur për publikun, duke mundësuar qasje transparente në të dhëna dhe nisma.

Vlerësimi ndërmjetës dhe përfundimtar

Në fund të vitit 2027 do të realizohet një vlerësim ndërmjetës, për të analizuar ritmin e zbatimit dhe për të bërë rregullime në plan, nëse është e nevojshme. Në vitin 2028, do të përgatitet raporti përfundimtar i zbatimit, që do të shërbejë si bazë për hartimin e planit të ardhshëm.



21. Bibliografi

Asambleja e Kombeve të Bashkuara. (1948). *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut*.

Kuvendi i Shqipërisë. (2016). *Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”*. Fletorja Zyrtare nr. 193, datë 14.11.2016.

Kuvendi i Shqipërisë. (2014). *Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”*. Fletorja Zyrtare nr. 215, datë 17.12.2015.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2020). *Standardet minimale për shërbimet sociale në komunitet për persona në nevojë*. Tiranë.

Këshilli i Ministrave. (2018). *VKM nr. 505, datë 13.09.2018 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shërbimeve sociale”*. Fletorja Zyrtare.

Këshilli i Ministrave. (2018). *VKM nr. 118, datë 13.3.2018 “Për procedurat e licencimit dhe akreditimit të ofruesve të shërbimeve sociale”*. Fletorja Zyrtare.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve. (2022). *Manuali për monitorimin e standardeve të shërbimeve për fëmijë*.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2021). *Udhëzues për menaxhimin e rasteve në shërbimet sociale komunitare*.

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). (2022). *Raporti për kapacitetet e njësive të vetëqeverisjes vendore në ofrimin e shërbimeve sociale*.

Save the Children Albania & UNICEF Albania. (2021). *Manual praktik për bashkitë për zhvillimin e shërbimeve sociale*.

Lista e legjislacionit të marrë në analizë

Ligji nr. 8417, datë 22.11.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar; (në veçanti Nenet 49, 51, 52, 55);

• Ligj nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;



- Ligji nr. 7531, datë 11.12.1991 “Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës (OKB)”;
- Ligji nr.7767, datë 9.11.1993 “Për aderimin në Konventën “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”;
- Ligji nr. 104/2012, datë 8.11.2012 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”;
- Ligji nr. 108 , datë 2012 “Për ratifikimin e Konventës së OKB -së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”;
- Ligji nr. 8137, datë 31.07.1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut” dhe Protokolli nr. 7 i KEDNj;
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Ligji nr. 8774, datë 23.4.2001 “Për ratifikimin e Konventës nr.182 “Format më të këqija të punës së fëmijëve, 1999” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës”;
- Ligj nr. 9359, datë 24.3.2005 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane “Për marrëdhëniet me fëmijët”;
- Ligji nr. 10 071, datë 9.2.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual”;
- Ligji nr. 10 425, datë 2/6/2011 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve;
- **Ligji nr. 121, datë 24.11.2016, ”Mbi Shërbimet e Kujdeist Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;**
- Ligji nr. 163/2014 “Për urdhërin e punonjësve social në Republikën e Shqipërisë “;
- Ligji nr. 40/2016, i ndryshuar “Për urdhërin e psikologut në Republikën e Shqipërisë»;
- **Ligji 18/2017 ”Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”;**
- **Ligji nr.9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”;**
- Ligji nr. 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar ;
- **Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;**



- Ligji 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”;
- Ligj nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, i ndryshuar;
- Ligj nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”, i ndryshuar;
- Ligj nr. 8626, datë 22.06.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar;
- Ligj Nr. 65/2016 datë 9.6.2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- Karta Europiane për Autonomi Lokale;
- VKM nr 597, datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” (ndryshuar me vendimin nr. 85, datë 10.2.2021;nr. 868, datë 29.12.2021; nr. 617, datë 22.9.2022);
- VKM nr. 182, datë 26.2.2020 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal” i ndryshuar;
- VKM nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre” i ndryshuar;
- VKM nr.31, datë 20.1.2001 “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar;
- VKM nr.78, datë 7.2.2007 “Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë”, i ndryshuar;
- VKM nr.869, datë 18.6.2008 “Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “statusi i invalidit”, i ndryshuar;
- VKM nr.277 date 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”;
- Vendim nr. 257, datë 5.5.2021 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale”;
- Vendim nr. 135, datë 7.3.2018 “Për miratimin e statutit të shërbimit social shtetëror”, i ndryshuar;



- Vendim nr. 617, datë 20.10.2021 “Për treguesit statistikorë të vlerësimit e të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore, si edhe periodicitetin e mbledhjes së tyre”;
- Vendim nr. 751, datë 1.12.2022 “Për një mbrojtje të veçantë nga shteti për gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç”;
- Vendim nr. 56, datë 31.1.2018 “Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara”;
- Vendim nr. 174, datë 24.3.2023 “Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2023–2025”;
- VKM Nr. 768 datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të vecanta”;
- VKM 518/2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”;
- **VKM Nr. 149, datë 13.3.2018 “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare”;**
- VKM 136/2018 “Për funksionimin dhe administrimin e regjistrit elektronik kombëtar të shërbimeve të kujdesit shoqëror”;
- VKM Nr. 135, datë 7.3.2018 “Për miratimin e statutit të shërbimit social shtetëror”;
- VKM Nr. 848, datë 28.10.2020 “Për standardet, kriteret e procedurat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe të ofruesve të tyre”;
- **VKM Nr. 624, datë 29.07.2020 “Për kriteret dhe procedurën e programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror”;**
- VKM nr. 111 datë 23 shkurt 2018 “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social;
- VKM Nr. 150 datë 20/03/2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.